



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2021

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
KORNIZA LIGJORE	10
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	10
Misioni i KPM-së është:	10
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	10
Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së.....	10
Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2021	11
Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2021	11
AKTIVITETET E KPM-së.....	12
Mbledhja e parë e KPM-së	12
Mbledhja e dytë e KPM-së	13
Mbledhja e tretë e KPM-së	15
Mbledhja e katërt e KPM-së	16
Mbledhja e pestë e KPM-së	17
Mbledhja e gjashtë e KPM-së	18
Mbledhja e shtatë e KPM-së (e jashtëzakonshme)	19
Mbledhja e tetë e KPM-së (e jashtëzakonshme).....	19
Mbledhja e nëntë e KPM-së.....	19
Mbledhja e dhjetë e KPM-së.....	21
Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së.....	22
Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së.....	22
Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së	22
Mbledhja e katërmëdhjetë e KPM-së.....	24
Mbledhja e pesëmbëdhjetë e KPM-së.....	24
Mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e KPM-së	25
Mbledhja e shtatëmbëdhjetë e KPM-së	26
Mbledhja e tetëmbëdhjetë e KPM-së.....	27
Mbledhja e nëntëmbëdhjetë e KPM-së	28
NDRYSHIMI NE KORNIZEN LIGJORE TE KPM-se.....	29
Vazhdimi i punës në ndryshimin e Ligjit të KPM-së	29
VAZHDIMI I PUNËS NË AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE.....	29
Konsultimi publik dhe miratimi i Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale	29

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	30
ANGAZHIMI DHE AKTIVITETET E KPM-SË GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE	31
Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme 2021 për Kuvendin e Republikës së Kosovës	31
Publikimi i raportit të monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet nacionale 2021.....	32
Përgatitjet për monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.....	33
Organizimi i tryezave regjionale.....	33
Vazhdimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të procesit zgjedhor	34
Publikimi i raporteve për monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2021 në Republikën e Kosovës.....	34
VLERËSIMI I PËRMBAJTJEVE TË LAJMEVE QENDRORE TË OSHMA-ve.....	36
MBROJTJA E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË MEDIA	36
Vlerësimi i përmbajtjeve programore	36
Pjesëmarrja e KPM-së në konferencën ndërkombëtare në Tiranë për mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive	38
Aktivitetet në kuadër të Edukimit Medial me fokus mbrojtën e fëmijëve në media	38
EDUKIMI MEDIAL	39
Organizimi i fushatës së KPM-së për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me përmbajtjet mediale	39
Organizimi i tryezës së diskutimit lidhur me përfaqësimin e fëmijëve dhe përfaqësimin gjinor në media	40
Aktivitetet në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Universitetit të Prishtinës	40
Aktivitetet në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Universitetit të Prishtinës	41
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	41
Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave, Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj) dhe Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) 41	
Nënshkrimi i Memorandum të Bashkëpunimit ndërmjet KPM-së dhe Fakultetit të Shkencave Politike, Departamenti i Komunikimit/Gazetarisë, Universiteti i Sarajevës	42
Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të KPM dhe ARKEP	43
Vazhdimi i bashkëpunimit të KPM-së me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)	43
Bashkëpunimi i KPM-së me Misionin Eksplorues të Zgjedhjeve	45
Vazhdimi i bashkëpunimit me Misionin e OSBE-së në Kosovë	45

Bashkëpunimi i KPM-së në kuadër të programit të BE-së dhe KE-së “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022	46
Konferenca regjionale e autoriteteve rregullatorë të mediave	46
Pjesëmarrja e KPM-së në takimin vjetor të European Platform Of Regulatory Authorities	47
(EPRA).....	47
Pjesëmarrja në Grupet Punuese në hartim të Udhëzimeve Administrative që derivojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës	47
Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Centre for Humanitarian Dialogue - CHD.....	47
Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Advocacy Training and Resource Center ATRC ...	48
Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Save the Children.....	48
Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Demokracia për Zhvillim.....	48
Pjesëmarrja e KPM-së në Asamblenë e 21-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullative - MNRA	48
Konferenca regjionale “Mbështetja teknike për mediat e shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor”	49
Organizmi i takimit me përfaqësuesit e operatorëve të shpërndarjes dhe atyre të VAPIK	50
Luftimi i piraterisë në fushën audiovizuale	50
Hartim i Draft Planit Strategjik trevjeçar.....	50
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	51
Burimet njerëzore.....	51
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	51
Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale	52
Mediat gjatë zgjedhjeve	52
Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve.....	54
Komunikimet Komerciale Audiovizuale	54
Raporti gjinor	55
Mbulimi i situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore.....	56
Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë.....	56
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	56
Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës	56
Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara dhe ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit:	56
Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara dhe ndarja e tyre sipas kategorisë së mbulimit	57

Numri Operatorëve të Shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale (OSH) të licencuar dhe ndarja e tyre sipas pronësisë:	57
Numri i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes dhe ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit:	57
Numri i kërkesave të proceduara	58
Gjatë vitit 2021, Departamenti i Licencimi ka trajtuar edhe 10 raste, prej tyre:	58
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	58
Rastet për transmetim ilegal - Shkelje e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 të KPM-së.....	59
Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor ...	59
Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale	59
Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM- 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës	60
Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.....	60
Rastet për zbatimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ...	60
Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së	60
Rastet për shkeljen Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale	60
Ankesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2021, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës	61
Rastet e shkeljeve gjatë procesit zgjedhor	65
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	66
Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge	66
Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)	66
Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)	67
Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal	68
Rastet për interferencë	68
Rastet për transmetime të palicencuar	68
Frekuencat e revokuara nga KPM.....	68
Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkpunimi me KFOR.....	68
Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit	69

Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së.....	69
Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë.....	69
Plani frekuencor dhe dixhitalizimi.....	69
Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë.....	69
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE	70
Buxheti.....	70
PUNA E BORDIT PËR ANKESA.....	73
Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa.....	73
Përbërja e Bordit për Ankesa gjatë vitit 2021	73
Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa	73
OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA PËR VITIN 2021	76
OBJEKTIVAT E VITIT 2022	77
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	78
Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare	78
Nevoja për rritjen e numrit të stafit.....	78
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2020.....	78
Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)	78

SHTOJCAT

- Shtojca I - Organogrami
- Shtojca II - Tabela e Rasteve Ligjore
- Shtojca III - Raporti Vjetor Financiar
- Shtojca IV - Raporti i Monitorimit “Mbrotjtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele”
- Shtojca V - Raporti i Monitorimit “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve”
- Shtojca VI - Raporti i Monitorimit “OSHMA-të gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021”
- Shtojca VII - Raporti i Monitorimit “Mbrotjtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele II”
- Shtojca VIII - Raporti i Monitorimit “OSHMA-të gjatë fushatës për zgjedhjet e për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 2021”
- Shtojca IX - Raporti i Monitorimit “OSHMA-të gjatë fushatës për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale (për Kryetar të Komunave) në Republikën e Kosovës 2021”
- Shtojca X - Raporti i Monitorimit “Monitorimi i paraqitjes së grave në debatet televizive gjatë fushatës për zgjedhjet lokale 2021”
- Shtojca XI - Raporti i Monitorimit “Prezantimi i fëmijëve në media në Kosovë”.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2021, të cilin ju përcjellim në pajtim me nenin 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti ofron një pasqyrë të punës së KPM-së kundrejt mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë të saj. Edhe këtë vit, sikurse edhe më 2020, për shkak të masave të shumta mbrojtëse kundër COVID 19, KPM-ja ka qenë e kufizuar në arritjen e të gjitha aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021. Për më tepër, gjatë vitit 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave nuk ka qenë i kompletuar. Në pjesën më të madhe të vitit Komisioni ka funksionuar me vetëm katër anëtarë. Mos kompletimi i Komisionit në një vit zgjedhor (me zgjedhje parlamentare dhe ato lokale) ka paraqitur një sfidë në vete.

Përkundër kësaj, KPM-ja ka arritur t'i realizojë shumicën e objektivave të saj, përfshirë amandamentimin dhe miratimin e akteve nënligjore, shqyrtimin e kërkesave për licencim, monitorimin e të licencuarve dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, gjatë vitit 2021, KPM-ja ka regjistruar 57 raste për shqyrtim të kërkesave për licencë të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, njoftime për heqje dorë nga licenca apo kërkesa për ndryshim të skemës programore. KPM-ja ka të licencuar 19 TV stacione, 89 radio stacione, 36 operatorë të shpërndarjes dhe 115 ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.

Në 19 mbledhjet e rregullta, KPM-ja ka shqyrtuar me dhjetra raste dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të Kodit të Etikës, Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale. Po ashtu, KPM-ja ka shqiptuar me dhjetra sanksione dhe gjoba lidhur me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i mediave para fushatës dhe gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme të mbajtura më 14 shkurt 2021, zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, dhe rundin e dytë të zgjedhjeve lokale më 14 nëntor 2021. Disa nga vendimet e KPM-së janë ankimuar tek Bordi për Ankesa, i cili gjatë vitit 2021, ka mbajtur dy seanca shqyrtuese, ku ka shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së.

Në procesin e dixhitalizimit, gjatë vitit 2021, KPM-ja përveç takimeve të zhvilluara me Zyrën e Kryeministrit për këtë çështje, ka vendosur në parim që të iniciohet procedura për lirimin e dividentës dixhitale dhe kanalet televizive në këto frekuenca të barten në frekuenca tjera. Ndërsa në vazhden e luftimit të piraterisë televizive, edhe këtë vit KPM ka bashkëpunuar ngushtë me ARKEP-in dhe Policinë e Kosovës.

Sa i përket avancimit të infrastrukturës ligjore, KPM-ja ka organizuar konsultime publike dhe ka miratuar Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

KPM i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të edukimit medial në të gjitha segmentet e shoqërisë, ngritjen e kapaciteteve për përdorim aktiv, kritik dhe kreativ të mediave dhe ndërgjegjësimin e shikuesve dhe dëgjuesve lidhur me të drejtat e tyre dhe përdorimin e sigurt të shërbimeve mediatike.

Në kuadër të rritjes së partneritetit me akterët vendor dhe ndërkombëtar, KPM-ja ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me disa institucione dhe organizata sikurse me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Universitetin e Sarajevës (US), Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive të Shqipërisë (AMA). Ndërsa, gjatë këtij viti KPM ka bashkëpunuar edhe me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së (EU EOM). Për më tepër, KPM-ja ka marrë pjesë në takimin e 54-të të EPRA-s dhe në Asamblenë e 21-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullative – MNRA dhe në ngjarje të tjera në vend dhe rajon.

Por, përveç kufizimeve të pandemisë dhe mospërbërjes së plotë të Komisionit, gjatë vitit 2021 Komisioni i Pavarur i Mediave është ballafaquar edhe me sfida të tjera. Një ndër to ka qenë edhe ndalimi nga institucionet e rendit dhe drejtësisë të dy zyrtarëve publik të Zyrës Ekzekutive të KPM-së. Përveç bashkëpunimit të plotë me institucionet e drejtësisë, Komisioni ka arritur që të bëjë zëvendësimet e duhura në mënyrë që të mos ndalet puna e KPM-së si rregullator medial.

Sfidë tjetër për KPM-në kanë qenë shkurtime buxhetore nga Ministria e Financave dhe mos lejimi i shfrytëzimit të të hyrave nga tarifat vjetore të licencave siç përcaktohet me Ligjin për KPM-në. KPM-ja është duke u ballafaquar edhe me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Në vazhdimësi KPM-ja ka parashtruar kërkesa për shtimin e numrit të stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërliken me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së.

Puna e KPM-së për vitin 2022 do të orientohet drejt arritjes së pesë objektivave kryesore. Objektivi i parë ka të bëjë me rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në fushën e mediave audio dhe audiovizuale. Objektivi i dytë synon ruajtjen dhe promovimin e pluralizmit medial në Kosovë, përmes rregulloreve specifike që parandalojnë koncentrimin e mediave. Objektivi i tretë ndërlihet me mbrojtjen e qytetarëve dhe grupeve të cënueshme nga përmbajtjet e dëmshme programore, përfshirë gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin. Ndërsa, dy objektivat e fundit kanë të bëjnë me përdorimin eficient të resurseve frekuencore dhe rritjen e efikasitetit dhe mirëqeverisjes institucionale. Raporti në vijim ofron një pasqyrë të detajuar të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Mediave, aktiviteteve të Zyrës Ekzekutive dhe punës së Bordit të Ankesave.

Mars 2022

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

KORNIZA LIGJORE

KPM-ja është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafi 2.8, të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: *“KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM-ja është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11, pika 2.1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: *“brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”*.

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2021

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar më	Kohëzgjatja e mandatit
Xhevat	LATIFI	Kryetar	16 tetor 2020	mandat dy (2) vjeçar
Granit	MUSLIU	Nënkryetar	16 tetor 2020	mandat dy (2) vjeçar
Azra	DEŠIĆ	Anëtare	16 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Violeta	HYSENI KELMENDI	Anëtare	më 17 prill 2018	mandat katër (4) vjeçar
Maja	SLAVIĆ	ish - Anëtare	më 17 prill 2018 deri më 17 prill 2021	mandat tre (3) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2021

Bazuar në Nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM me 18 shkurt 2021 ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për një anëtarë të KPM-së, nga komunitetet jo shumicë. Afati për nominimin ka qenë 15 ditë, prej: 18 shkurt 2021 deri më 4 mars 2021. Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në dhe të gjitha nominimet e pranuar janë përcjellur sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, bazuar në Nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, më 29 prill 2021, KPM ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për tre (3) anëtarë të KPM-së: dy (2) nga radhët e komunitetit shqiptar dhe një (1) nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës. Afati i nominimit ka qenë 15 ditë, prej: 29 prill 2021 deri më 14 maj 2021. Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në dhe të gjitha nominimet e pranuar janë përcjellur sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, bazuar në Vendimin 08-V-054 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas Nenit 11, pika 2.1, dhe të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM më 13 gusht 2021 ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për tre (3) anëtarë të KPM-së: dy (2) nga radhët e

komunitetit shqiptar dhe një (1) nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës. Afati për nominime ka qenë i hapur për 15 ditë, prej: 13 gusht 2021 deri më 27 gusht 2021.

Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në dhe të gjitha nominimet e pranuar janë përcjellur sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2021, KPM-ja ka mbajtur nëntëmbëdhjetë (19) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në.

Në vazhdim paraqiten në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur rastet e trajtuara dhe vendimet e marra nga Komisioni gjatë seancave të mbledhjeve të rregullta të vitit 2021.

Mbledhja e parë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 28 janar 2021, ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2021. Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale dhe Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale. Rastet ligjore të shqyrtuara nga Komisioni i KPM-së janë paraqitur në vijim:

- Kujtesa Net vs Klan Kosova - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se OSHMA Klan Kosova nuk ka vepruar në shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2020/01. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa e operatorit Kujtesa Net të refuzohet si e pabazuar.
- Telkos vs Klan Kosova - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se OSHMA Klan Kosova nuk ka vepruar në shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2020/01. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa e operatorit Telkos të refuzohet si e pabazuar.
- Shell vs Radio Kosova1 dhe Glam Radio - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se OSHMA Radio Kosova 1 dhe Glam Radio kanë vepruar në pajtueshmëri me nenin 6, paragrafi 5, të Rregullores KPM-2017/07. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa e Shell të refuzohet si e pabazuar.
- Orange Net vs Klan Kosova - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se Klan Kosova ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03. Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA Klan Kosova me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
- Fiber Link vs Klan Kosova - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se OSHMA Klan Kosova nuk ka vepruar në shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2020/01. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa e operatorit Fiberlink të refuzohet si e pabazuar.

- Kadria Net vs Klan Kosova - pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se OSHMA Klan Kosova nuk ka vepruar në shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores KPM-2020/01. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa e operatorit Kadria Net të refuzohet si e pabazuar.
- Devolli Grup vs RTK1 – pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se RTK 1 ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03. Komisioni vendosi që RTK 1 të sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së.

Komisioni ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit, kërkesa këto që kishin të bënin me licencimin e ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes rrjetit të OSH-ve, kërkesë për ndryshim të pronësisë dhe emrit dhe një kërkesë për ndërprerjen e vendimit për licencim të operatorit të shpërndarjes. Rastet e licencimit të shqyrtuara nga Komisioni janë të renditura në vijim:

- Klina TV - Vendim për lëshimin e licencës për OSHMA me transmetim përmes rrjetit të OSH-ve;
- Radio Drenica - Vendim për ndryshim të pronësisë dhe emrit;
- Advan Tech Shpk - Vendim për ndërprerjen e vendimit për licencim të Operatorit të Shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive, për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka konstatuar se të gjitha aplikacionet i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe i ka miratuar të gjitha rekomandimet.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin Tremujor të punës së KPM-së, për periudhën tetor-dhjetor 2020. Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar Raportin tremujor, i cili përcillet në Kuvendin e Republikës së Kosovës bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Sa i përket punës së KPM-së rreth përgatitjeve për monitorimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat janë mbajtur më 14 shkurt 2021, Komisioni ka shqyrtuar plotësim/ndryshimin e Udhëzuesit të KPM-së për sjelljen e mediave gjatë zgjedhjeve. Pas shqyrtimit Komisioni ka miratuar Udhëzuesin e ndryshuar.

Mbledhja e dytë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 11 shkurt 2021, ka mbajtur mbledhjen e dytë të rregullt. Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar rastet ligjore lidhur me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) para fushatës dhe gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme të mbajtura më 14 shkurt 2021, për Kuvendin e Republikës së Kosovës. KPM ka kryer monitorimin e mediave para dhe gjatë fushatës zgjedhore, për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat që kishin të bënin me shkelje të legjislacionit të Komisionin e Pavarur të Mediave, respektivisht Ligjit për KPM-në, Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet

Komerciale Audio-vizuele si dhe të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe pas shqyrtimit ka konstatuar se në të gjitha këto raste subjektet janë gjetur në shkelje të legjislacionit. Për rastet ligjore të shkeljeve që KPM ka identifikuar para fillimit të fushatës zgjedhore, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- Kanal 10 - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- Klan Kosova - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- KTV - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- RTK 1 - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- TE 7 - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Ndërsa, për rastet ligjore të shkeljeve që KPM ka identifikuar gjatë fushatës zgjedhore, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- Kanal 10 - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- TE 7 - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- TV Dukagjini - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 7500 € (shtatëmijë e pesëqind euro), për shkelje të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- Klan Kosova - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- KTV - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
- RTK 1 - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- TV Syri Vision - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 2000 € (dymijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- TV Puls - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 2000 € (dymijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Mbledhja e tretë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 16 mars 2021, ka mbajtur mbledhje e tretë të rregullt.

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar disa raste ligjore që lidhen me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme të mbajtura më 14 shkurt 2021, për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së mediave me zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, ka bërë monitorimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale gjatë heshtjes zgjedhore. Në bazë të gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore lidhur me shkeljen e legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave, respektivisht Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale si dhe të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe ka konstatuar se në të gjitha këto raste subjektet janë gjetur në shkelje të legjislacionit. Pas shqyrtimit të rasteve ligjore të shkeljeve, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- Kanal 10 - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- TE 7 - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- TV 21 - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të shkelje Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- TV Mir - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 2000 € (dymijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- ATV - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- TV Dukagjini - është sanksionuar me masën gjobë në vlerë prej 5000 € (pesëmijë euro), për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- Klan Kosova - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- TV Festina - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- Klan Kosova - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Kodit të Etikës;
- TV Syri Vision - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Kodit të Etikës;
- TV Dukagjini - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Kodit të Etikës;
- TV Vali - është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07.

Në vazhdim të mbledhjes, Komisioni ka trajtuar disa kërkesa në rastet e licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesë për frekuenca shtesë për radio, kërkesa për licencimin e OSHMA përmes operatorit të shpërndarjes dhe kërkesë për ndryshim të pronësisë. Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 - Vendim për frekuenca shtesë;
- TV M - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- TV Film Premier - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- TV Kalamajt - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- ISP Aksion - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- ISP Hits - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- ISP Dramë - Vendim për lëshim të licencës për OSHMA përmes OSH-ve;
- Radio dhe TV Festina - Vendim për ndryshim të pronësisë.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të lartcekura, Komisioni ka konstatuar se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka miratuar të gjitha rekomandimet.

Gjithashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar vendimin për pezullimin e përkohshëm të lëshimit të licencave për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes. Pas shqyrtimit, Komisioni ka vendosur të pezullohet përkohësisht lëshimi i licencave për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes, deri në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të reja për licencimin e tyre. Gjithashtu, lidhur me këtë çështje, Komisioni ka vendosur që të iniciohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02.

Mbledhja e katërt e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 16 prill 2021, ka mbajtur mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2021. Komisioni ka shqyrtuar Raportin tremujor të punës së KPM-së, për periudhën janar-mars 2021. Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar Raportin tremujor, i cili bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcillet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka trajtuar disa kërkesa në rastet e licencimit, që kishin të bënin me licencimin e ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes rrjetit të OSH-ve, kërkesë për ndryshim të emrit.

Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- ISP Pikëpyetje - Vendim për lëshimin e licencës për OSHMA;
- ISP Dokumentar - Vendim për lëshimin e licencës për OSHMA;
- ISP Popullore - Vendim për lëshimin e licencës për OSHMA;

- AAB Radio - Vendim për ndryshimin e emrit.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka gjetur se të gjitha aplikacionet i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe vendosi të miratojë të gjitha rekomandimet.

Ndërsa, sa i pikës tjetër që ishte në rend dite, atë të rasteve ligjore lidhur me shkeljen e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht për mos sjellje të ditarëve A dhe B, pas diskutimit për këtë pikë, Komisioni vendosi që vendimin ta shtyjë për mbledhjen e radhës.

Mbledhja e pestë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 26 maj 2021, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt. Sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit, që kishin të bënin me licencimin e ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA) me transmetim përmes rrjetit të OSH-ve, kërkesë për ndryshim të emrit, kërkesë për ndryshim të pronësisë, kërkesë licencim të Operatorit të Shpërndarjes.

Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- Kiki Net SHPK - Vendim për licencim të Operatorit të Shpërndarjes;
- TV Festina - Vendim për ndryshim të pronësisë.
- RTV Dukagjini - Vendim për licencimin e OSHMA me transmetim përmes OSH-ve;
- TG TV - Vendim për ndryshimin e emrit në Target.
- Paper TV - Vendim për licencimin e OSHMA me transmetim përmes OSH-ve.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka gjetur se të gjitha aplikacionet i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe vendosi të miratojë të gjitha rekomandimet.

Në lidhje me shkeljet e evidentuara gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme 2021, KPM ka iniciuar disa raste ligjore për mos sjellje të ditarëve A dhe B, të cilat kishin të bëjnë me shkelje të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM.

Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe ka konstatuar se këto OSHMA: Kanal 10, TE7 , Radio 7, Top Radio, Radio Gjilani, Radio Rinia, Radio Victoria, TV Vali, Radio Max, Radio 7 Kosova, Radio Club FM, Radio Prishtina, Radio Urban FM Prishtinë, Radio Dardania, Radio Helix, Radio Urban FM Prizren, kanë vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet, duke mos i sjellë Ditarët A dhe B.

Prandaj, Komisioni ka vendos që këto OSHMA të sanksionohen me masën sanksionuese me gjobë, në shumën prej një mijë (1000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka trajtuar edhe disa raste ligjore:

- Ankesa e znj. Ervehe Gashi ndaj TV Dukagjinit - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka ardh në përfundim se nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara nga pala ankuese, prandaj vendosi se Ankesa e znj. Ervehe Gashi, përmes së cilës pretendohet se OSHMA TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03, të refuzohet si e pabazuar.
- Ankesa e Telkos ndaj Klan Kosova - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka ardh në përfundim se nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara nga pala ankuese, prandaj vendosi se saktësia e të dhënave të transmetuara nga Klan Kosova nuk mund të vërtetohet dhe se Pala ankuese me qëllim të kundërshtimit të këtyre të dhënave, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit sipas nenit 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Komisioni gjithashtu ka diskutuar edhe për çështjen e inicimit të procedurës së ndryshimit të Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, sa i përket kriterëve dhe procedurave për lëshimin e licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes, Komisioni vendosi që të iniciohet procedura dhe të themelohet Grupi Punues për Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02.

Mbledhja e gjashtë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 2 qershor 2021, ka mbajtur mbledhje e gjashtë të rregullt.

Në këtë mbledhje sipas rendit të ditës, KPM ka shqyrtuar disa raste ligjore, respektivisht ankesa të palëve lidhur me Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Rastet e shqyrtuara ligjore janë të renditura në vijim:

- Ankesa e Telkos ndaj OSHMA Klan Kosova - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni erdhi në përfundim se nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara, prandaj vendosi se Ankesa e operatorit TELKOS, përmes së cilës pretendohet se OSHMA Klan Kosova ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01, të refuzohet si e pabazuar.
- Ankesa e Telkos ndaj OSHMA TV Dukagjini - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni erdhi në përfundim se nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara, prandaj vendosi se Ankesa e operatorit TELKOS, përmes së cilës pretendohet se OSHMA TV Dukagjini ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01, të refuzohet si e pabazuar.

- Ankesa e Telkos ndaj OSHMA TE 7 - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni erdhi në përfundim se nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara, prandaj vendosi se Ankesa e operatorit TELKOS, përmes së cilës pretendohet se OSHMA TE7 ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01, të refuzohet si e pabazuar.

Mbledhja e shtatë e KPM-së (e jashtëzakonshme)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 1 korrik 2021, ka mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme, pas situatës së krijuar me ndalimin nga institucionet e rendit dhe drejtësisë të dy zyrtarëve publik të Zyrës Ekzekutive të KPM-së.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka diskutuar për situatën e krijuar në Zyrën Ekzekutive dhe pas shqyrtimit ka kërkuar një interpretim nga Departamenti Ligjor i KPM-së se si të procedohet tutje sipas obligimeve ligjore.

Komisioni ka shprehur edhe një herë gatishmërinë që të ofrojë bashkëpunim të plotë me institucionet e drejtësisë në mënyrë që të ndihmojë në zhvillimin e hetimeve deri në përfundim të rastit.

Mbledhja e tetë e KPM-së (e jashtëzakonshme)

Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur edhe një mbledhje të jashtëzakonshme më 2 korrik 2021.

Pas rekomandimeve të pranuar nga Departamenti Ligjor lidhur me procedurat për zëvendësimin e Kryeshefit Ekzekutiv pas ndalimit të tij nga institucionet e drejtësisë, Komisioni vendosi që të pezullojë nga detyra z. Luan Latifi, deri në një vendim tjetër. Vendimi u mor në përputhje me dispozitat e parapara me Ligjin e Punës. Gjithashtu, Komisioni ka vendosur që z. Faruk Rexhaj, Drejtor i Departamentit të Prokurimit, të caktohet Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së, nga data 2 korrik 2021 deri në një vendim tjetër.

Ndërsa, pas pranimi të detyrës, z. Rexhaj ka marrë vendim që Drejtori i Administratës dhe Financave z. Arben Bilalli, i cili është ndaluar nga institucionet e drejtësisë, të pezullohet nga ushtrimi i detyrës, deri në një vendim tjetër dhe në këtë pozitë të zëvendësohet nga znj. Ganimete Nuçi.

Mbledhja e nëntë e KPM-së

Më 29 korrik 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur mbledhjen e nëntë të rregullt.

Në këtë mbledhje sipas rendit të ditës, KPM ka shqyrtuar rastet ligjore që lidhen me shkeljen e Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, respektivisht nenit 28, paragrafi 1, i cili përcakton se: *“Shërbimet e licencuara mediale audiovizuele duhet t’i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të*

tjera të parapara me ligj”. Pra, Ofruesi i Shërbimit Medial Audiovizuel (OSHMA), në bazë të nenit 28 të Ligjit të KPM-së, është i obliguar të dorëzojë raportin vjetor në KPM, përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera. Komisioni i Pavarur i Mediave ka gjetur se edhe pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, OSHMA-të e renditura më poshtë, kanë dështuar të veprojnë në pajtim me Ligjin e KPM-së, duke mos dorëzuar raportin vjetor për vitin 2020. Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe pas shqyrtimit ka ardhur në përfundim se në të gjitha këto raste subjektet janë gjetur në shkelje të legjislacionit. Pas shqyrtimit të rasteve ligjore të shkeljeve, Komisioni vendosi që të sanksionohen me masën **Vërejtje** OSHMA-të e renditura në vijim: Radio Dodona, Rapital Fm, Radio 7 Kosova, Radio Kent FM, Radio Club Fm, Top Iliria Radio, Radio Criteria Obiliq, Radio Kent FM2, Radio Urban FM, TV Zoom, TV Kosova Channel, Olti TV, Mbtv, TV Diaspora, A9 International, TVR, TV Dialog, Premier Songs, TV Llapi, Labia TV, Balkan Hot, Balkan Hot 2, TV Tajna, Telebet, Decija TV, American TV of Kosova dhe Click Channel.

Gjithashtu, lidhur me shkeljen e nenit 28 të Ligjit për KPM-në, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shqyrtuar rastet ligjore për disa OSHMA të cilat janë sanksionuar në vitin 2020 me Vërejtje për shkelje të nenit 28 të Ligjit të KPM-së, për mos sjellje të raportit vjetor për vitin 2019. Edhe përkundër vendimit sanksionues të KPM-së, ato kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me nenin 28 të Ligjit të KPM-së. Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe ka konstatuar se këto OSHMA janë gjetur në shkelje të legjislacionit, prandaj vendosi që OSHMA-të në vijim: Radio Capital Fm, Radio Urban Fm Prizren, Radio Kent Fm Prishtinë, Radio Urban Fm, Radio Kent Fm 2 Mamushë dhe Tribuna Channel, sanksionohen me masën sanksionuese me gjobë, në shumën prej një mijë (1000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së.

Në këtë mbledhje është shqyrtuar edhe një ankesë:

- Ankesa e z. Shkëlzen Morina nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ndaj KTV - pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka gjetur se sa i përket pretendimeve për shkelje, për pasaktësi, balancim, njëanshmëri, sulme personale, cenim të të drejtave individuale, KTV ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM 2016/03. Ndërsa, sa i përket pretendimit të MPJD-së lidhur me të drejtën e reagimit, KPM ka gjetur KTV me mos transmetimin e plotë të reagimit të Palës Ankuese ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Prandaj, Komisioni ka vendosur të sanksionojë KTV me Vërejtje si dhe ta obligojë KTV-në që në afat prej (7) ditësh të transmetojë reagimin e palës ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për ndërprerje të licencës së operatorit të shpërndarjes dhe kërkesa për ndryshim të pronësisë. Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- Eagle - Vendim për ndërprerje të licencës së Operatorit të Shpërndarjes;
- Radio Festina - Vendim për ndryshim të pronësisë;
- Paper Radio - Vendim për ndryshim të pronësisë;

- Connect ISP - Vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes; dhe
- TV Syri Vision - Vendim për ndryshim të pronësisë.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të lartcekura, Komisioni erdhi në përfundim se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe vendosi të miratojë të gjitha rekomandimet.

Komisioni ka diskutuar lidhur me vendimin e KPM-së për pezullim të licencimit të OSHMA-ve përmes operatorëve të shpërndarjes. Duke marr për bazë faktin se pas inicimit të procedurës për ndryshimin e Rregullores janë vërejtur çështje të cila kërkojnë kohë më të gjatë për vlerësim, si dhe se procedurat për ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përfshirë rishikimin e kriterëve për licencim kërkojnë kohë relativisht të gjatë, Komisioni vendosi që pezullimi i lëshimit të licencave të ndërpritet. Me këtë vendim është hapur rruga për shqyrtimin e kërkesave eventuale për licencim dhe paralelisht me këtë, grupi punues të punojë për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02.

Vlen të theksohet se gjatë kohës sa ishte pezulluar licencimi i OSHMA-ve përmes operatorëve të shpërndarjes, KPM nuk kishte pranuar asnjë kërkesë për licencim.

Mbledhja e dhjetë e KPM-së

Më 17 gusht 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka mbajtur mbledhjen e dhjetë për këtë vit. Në këtë mbledhje sipas rendit të ditës, KPM ka shqyrtuar rastet ligjore që lidhen me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) gjatë monitorimit të kryer nga KPM nga data 22 deri më 28 maj 2021.

Komisioni i Pavarur i Mediave, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së mediave me Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale si dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, ka bërë monitorimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale gjatë datave 22 deri 28 maj 2021. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të lartpërmendur të KPM-së për këto OSHMA: TV21, TV Dukagjini, Klan Kosova dhe Kanal 10.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto raste të shkeljeve ligjore dhe pas shqyrtimit ka ardhë në përfundim se në të gjitha këto raste subjektet janë gjetur në shkelje të legjislacionit. Pas shqyrtimit të rasteve ligjore të shkeljeve, Komisioni vendosi si në vijim:

- Të obligojë OSHMA-të e lartpërmendura që në afat prej dhjetë (10) ditësh të bëjnë kategorizimin e përmbajtjeve programore të cilat i transmetojnë, t'i paralajmërojnë ato para fillimit me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizuel gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01.
- Të sanksionojë OSHMA-të e lartpërmendura me masën sanksionuese Vërejte, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkeljet e evidentuara.

Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së

Më 17 shtator 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë me radhë për këtë vit. Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar Draft Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Medial Audio dhe Audiovizuale, të përgatitur nga grupi punues i KPM-së.

Pas shqyrtimit të draftit, Komisioni ka sugjeruar disa ndryshime dhe pas përfshirjes së tyre, e ka aprovuar për diskutim publik. Bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM u ka bërë ftesë publike përfaqësuesve të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim për draft rregulloren e lartpërmendur.

Periudha e përcaktuar për komente publike me shkrim ka përfshirë periudhën nga data 27 shtator deri më 15 tetor 2021¹.

Gjithashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka trajtuar edhe një kërkesë për ndryshim të pronësisë:

- BB Herc - Vendim për refuzimin e kërkesës për ndryshim të pronësisë.

Pas shqyrtimit të rekomandimit të Zyrës Ekzekutive për këtë rast, Komisioni erdhi në përfundim se kjo kërkesë nuk i ka plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe vendosi të refuzojë kërkesën për ndryshim të pronësisë.

Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së

Më 30 shtator 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt. Në këtë mbledhje, sipas rendit të ditës, është diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e aktiviteteve të KPM-së gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore. Në mbledhje ishte diskutuar për të gjeturat nga monitorimi dhe hapat e mëtejshme procedurale që do të ndiqen. KPM ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me të licencuarit e saj, duke ua rikujtuar obligimet që dalin nga korniza ligjore për zgjedhje dhe duke u kërkuar të jenë të pajtueshmëri me këtë.

Gjithashtu, ishte diskutuar edhe për veprimet e mëtejme që KPM-ja do të ndërmerr sa i përket procesit të dixhitalizimit pas dy takimeve të zhvilluara të KPM-së me Zyrën e Kryeministrit për këtë çështje, mbrojtjes së fëmijëve në shërbimet mediale audio-vizuale pas monitorimeve të bëra në këtë fushë si dhe luftimit të piraterisë televizive, për të cilën KPM bashkëpunon ngushtë me ARKEP-in, Policinë dhe organet e drejtësisë.

Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 18 tetor 2021, ka mbajtur mbledhjen e trembëdhjetë të rregullt.

¹ Ky afat është vendosur të shtyhet edhe për një javë duke pasur parasysh se për shkak të dinamikës së punës së KPM-së, por edhe të mediave me përcjellje të aktiviteteve të fushatës zgjedhore, palët nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të analizuar draft rregulloren dhe për të dhënë komente. Rrjedhimisht KPM kishte pranuar komente vetëm nga dy palë, andaj ky afat është shtyrë deri me 22 tetor 2021. Më shumë për këtë do të raportojmë në tremujorin e radhës

Sipas rendit të ditës, KPM ka shqyrtuar rastet ligjore që lidhen me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.

Komisioni i Pavarur i Mediave, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së mediave me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, që vlen edhe për Zgjedhjet Lokale, dhe aktet nënligjore të KPM-së, ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore, të cilat kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha këto raste dhe pas shqyrtimit kishte vendosur si në vijim:

- Kanal 10 sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- Klan Kosova sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- RTK 1 sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- TE7 sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073;
- TV Dukagjini sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073;
- KTV sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka trajtuar disa kërkesa për licencim të OSHMA-ve përmes operatorëve të shpërndarjes dhe një kërkesë për ndryshim të emrit. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive, Komisioni ka konstatuar se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka miratuar të gjitha rekomandimet. Rastet e licencimit janë të renditura në vijim:

- TëVë Aksion - Vendim për licencim;
- TëVë Dramë - Vendim për licencim;
- TëVë Fantasy - Vendim për licencim;
- TëVë Comedy - Vendim për licencim;
- TëVë Novela - Vendim për licencim;
- TëVë Shqip - Vendim për licencim;
- TëVë Kids 1 - Vendim për licencim;

- TëVë Kids 2 - Vendim për licencim;
- TëVë Doku 1 - Vendim për licencim;
- TëVë Doku 2- Vendim për licencim;
- OSHMA TARGET - Vendim për ndryshimin e emrit në TëVë 1.

Mbledhja e katërbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 20 tetor 2021, ka mbajtur mbledhjen e katërbëdhjetë të rregullt.

Sipas rendit të ditës, KPM ka shqyrtuar rastet ligjore që lidhen me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha rastet dhe kishte vendosur si në vijim:

- ATV sanksionohet me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) euro për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07;
- TV 21 sanksionohet me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) euro për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- TV Festina sanksionohet me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07;
- TV Puls sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- TV Most sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
- RTK 1 sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- TE 7 sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Kanal 10 sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- TV 21 sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Klan Kosova sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Mbledhja e pesëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 9 nëntor 2021, ka mbajtur mbledhjen e pesëmbëdhjetë të rregullt.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar disa kërkesa për rastet e licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për licencimin e OSHMA-ve përmes operatorëve të shpërndarjes,

ndryshim të pronësisë, ndërprerje të licencës dhe ndryshim të kategorisë së licencës. Komisioni i kishte shqyrtuar kërkesat dhe kishte vendosur:

- VGN - pas shqyrtimit të rekomandimit për refuzimin e kërkesës për licencë, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së, prandaj ka vendosur që kjo kërkesë të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës;
- Radio Plus - pas shqyrtimit të rekomandimit për ndryshim të pronësisë, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së, prandaj ka vendosur që kjo kërkesë të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës;
- Radio dhe TV Iliria - pas shqyrtimit të rekomandimit për ndryshim të pronësisë, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë këtë kërkesë;
- N.SH. Klinet - pas shqyrtimit të rekomandimit për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur t'ia ndërprejë licencën këtij operatori;
- Radio Dardania - pas shqyrtimit të rekomandimit për ndryshim të pronësisë, Komisioni ka kërkuar sqarime shtesë nga Zyra Ekzekutive, duke e shtyrë këtë kërkesë për vendimarrje në mbledhjen e radhës, deri në sqarimet e mëtutjeshme nga Zyra;
- TDS SHPK - Pas shqyrtimit të kërkesës për heqje dorë nga licenca, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur t'ia ndërprejë licencën këtij operatori;
- Radio CAMPUS - pas shqyrtimit të rekomandimit për ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në regjionale, Komisioni ka kërkuar nga Zyra Ekzekutive sqarime shtesë, duke vendosur që ky rast të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës, deri në sqarimet e mëtutjeshme nga Zyra.

Mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 11 nëntor 2021, ka mbajtur mbledhjen e gjashtëmbëdhjetë.

Komisioni ka diskutuar për ecurinë e punës në monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar komune, të cilat u mbajtën më 14 nëntor 2021.

Për të gjitha rezultatet nga monitorimi i OSHMA-ve, KPM ka ndjekur të gjitha hapat dhe procedurat ligjore deri në shqyrtimin e rasteve nga Komisioni. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që vlen edhe për Zgjedhje Lokale, dhe legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave. Pas shqyrtimit të të gjitha rasteve ligjore, Komisioni kishte vendosur si në vijim:

- TV Dukagjini - sanksionohet me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07;
- TE7 - sanksionohet me gjobë në shumën prej katërmijë (4,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07 dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Klan Kosova - sanksionohet me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07;
- Kanal 10 - sanksionohet me gjobë në shumën prej katërmijë (4,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07 dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- KTV - sanksionohet me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM-2017/07;
- Kanal 10 - Ankesë nga Kushtrim Brahimaj - sanksionohet me Vërejtje për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Mbledhja e shtatëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 16 nëntor 2021, ka mbajtur mbledhjen e shtatëmbëdhjetë të rregullt.

Komisioni ka diskutuar për monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA) gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar komune, të mbajtura më 14 nëntor 2021.

Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që vlen edhe për Zgjedhje Lokale, dhe legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe në përgjithësi mediat gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore kanë vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesë për licencim, kërkesa për ndryshim të pronësisë, ndërprerje të licencës dhe ndryshim të kategorisë së licencës. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka vendosur:

- VGN - refuzohet kërkesa për licencë për shkak të moskompletimit të dokumentacionit nga pala;
- Radio Plus - miratohet kërkesa për ndryshim të pronësisë;
- Radio Dardania - miratohet kërkesa për ndryshim të pronësisë;
- Radio CAMPUS - miratohet kërkesa për ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në regjionale;

- Radio Kent FM - miratohet kërkesa për ndryshim të pronësisë dhe bartje të licencës, ndryshim të emrit dhe skemës programore;
- Radio Kent FM 2 - refuzohet kërkesa për ndryshim të pronësisë dhe bartje të licencës, ndryshim të emrit, skemës programore, gjuhës së transmetimit si dhe kategorisë së licencës për shkak se kjo frekuencë është ndarë për komunitetin turk në Mamushë;
- Top Iliria Radio - miratohet kërkesa për ndryshim të pronësisë dhe bartje të licencës, ndryshim të emrit dhe skemës programore.

Gjithashtu, Komisioni ka diskutuar edhe për çështjen e lirimit të dividendës dixhitale nga transmetimi radiodifuziv tokësor, që aktualisht është duke u përdorur nga disa televizione për transmetim tokësor. Pas shqyrtimit të kësaj pike, Komisioni ka vendosur në parim që të iniciohet procedura për lirimin e dividendës dixhitale dhe kanalet televizive në këto frekuenca të barten në frekuenca tjera.

Komisioni kishte diskutuar edhe për procesin e punës që është duke e zhvilluar Grupi Punues për hartimin e Strategjisë së punës së KPM-së, për objektivat dhe prioritet që duhet të përcaktohen në Strategjinë e punës së KPM-së. Pas diskutimeve, Komisioni u pajtua që të vazhdohet puna në finalizimin sa më parë të këtij dokumenti. Në këtë mbledhje është diskutuar edhe për procesin e dixhitalizimit dhe draft-rregullores për pronësinë.

Mbledhja e tetëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 7 dhjetor 2021, ka mbajtur mbledhjen e tetëmbëdhjetë të rregullt.

Komisioni ka shqyrtuar draftin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Lidhur me procesin e amandamentimit të akteve nënligjore, KPM duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2, pika 11, të Ligjit për KPM, ka iniciuar procedurën për amandamentimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, pas shqyrtimit të draftit, Komisioni ka vendosur të miratojë Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale². Me miratimin e kësaj rregullore është shfuqizuar Rregullorja KPM-2017/02.

Komisioni poashtu ka shqyrtuar kërkesën e ish kryeshefit ekzekutiv, Luan Latifi, për kthim në vendin e punës. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, konkretisht në nenin 18 të këtij Ligji, si dhe duke u bazuar në nenin 69, paragrafi 1, pika 1.1, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komisioni ka vendosur që t'i

² <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20p%C3%ABr%20Ofruesit%20e%20Sh%C3%ABrbimeve%20Mediale%20Audio%20dhe%20Audiovizuale%20KPM%202021-01.pdf>

vazhdohet masa e pezullimit dhe të gëzojë të drejtën e kompensimit në pagë në lartësi prej 50% ashtu siç përcaktohet me nenin 69, paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-149.

Mbledhja e nëntëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 21 dhjetor 2021, ka mbajtur mbledhjen e nëntëmbëdhjetë të rregullt.

Komisioni i Pavarur i Mediave me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së mediave me aktet nënligjore të KPM-së, ka bërë monitorimin e tyre. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe një rast për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, që vlen edhe për Zgjedhje Lokale.

Komisioni i ka shqyrtuar këto raste dhe pas shqyrtimit kishte vendosur si në vijim:

- Ankesë nga Corint Media Gmbha ndaj Kujtesa Net - Vendim për miratim të ankesës;
- TE7 - sanksionohet me gjobë në vlerë prej njëmijë (1000) euro, për shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (mos-dorëzimi i ditarëve për Zgjedhje);
- Klan Kosova - sanksionohet me gjobë në vlerë prej njëmijë (1000) euro, për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, Rregullores për Komunikime Komerciale dhe Kodit të Etikës;
- KTV - sanksionohet me Vërejtje, për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve;
- TV Dukagjini - sanksionohet me gjobë në vlerë prej njëmijë (1000) euro, për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve dhe Rregullores për Komunikime Komerciale.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar edhe një rast të licencimit, që kishte të bënte me kërkesë për ndërprerje të licencës së operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të rekomandimit të Zyrës Ekzekutive për rastin, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore dhe kishte miratuar kërkesën:

- IPTV Shqip - Vendim për ndërprerje të licencës së operatorit të shpërndarjes.

Gjithashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar dy rregullore të organizimit të brendshëm të stafit të KPM-së: Rregulloren për Zgjidhjen e Ankesave në KPM dhe Rregulloren për Disiplinë në KPM. Pas shqyrtimit Komisioni i ka miratuar në parim këto dy rregullore.

Në mbledhje është diskutuar poashtu edhe identifikimi i operatorëve ilegal nga ana e KPM-së dhe Komisioni ishte pajtuar që Zyra Ekzekutive të përgatis rekomandimet për rastet individuale dhe

pastaj të njejtat të prezantohen tek Komisioni për vendimmarrje. Në këtë mbledhje ishte diskutuar edhe për modalitetet e procesit të dixhitalizimit. Për shkak të kompleksitetit të këtij procesi dhe implikimeve financiare, Komisioni u dakordua që fillimisht të takohet me Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për të diskutuar modalitetet për procesin e dixhitalizimit, duke përfshirë financimin e tij. Komisioni kërkoi nga Zyra Ekzekutive që të bëjë kërkesë zyrtare për takim me Komisionin Parlamentar.

NDRYSHIMI NE KORNIZEN LIGJORE TE KPM-se

Vazhdimi i punës në ndryshimin e Ligjit të KPM-së

Sipas Planit të Veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është paraparë edhe ndryshimi/amandamenti i Ligjit për KPM-në. Në lidhje me këtë, janë mbajtur disa takime në mes të përfaqësuesve të KPM-së dhe përfaqësuesve nga Zyra e Kryeministrit. Takimet janë mbajtur më 18, 24, 26 gusht 2021 dhe 02 shtator 2021.

Puna ka vazhduar edhe gjatë pjesës së dytë të vitit, ku janë mbajtur disa takime në mes të përfaqësuesve të KPM-së dhe përfaqësuesve nga Zyra e Kryeministrit. KPM ka ofruar sugjerimet e saj për ndryshimet e nevojshme në projektligj, të cilat më pas janë shqyrtuar edhe në grupin punues të kryesuar nga ZKM. Projektligji është nxjerrë në konsultim publik nga ana e Qeverisë dhe komentet e pranuar me shkrim dhe ato gjatë dëgjimit publik, janë shqyrtuar në një punëtori të përbashkët të ZKM-së dhe KPM-së.

VAZHDIMI I PUNËS NË AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Konsultimi publik dhe miratimi i Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Në bazë të vendimit të KPM-së të mbledhjes së mbajtur me 23 mars 2021, është krijuar Grupi Punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullore - 2017/02). Qëllimi i formimit të këtij Grupi Punues ishte rishikimi i Rregullores KPM-2017/02. Grupi punues, pas disa takimeve të mbajtura, e ka prezantuar para Komisionit drafte fillestar dhe pas sugjerimeve të Komisionit, ka finalizuar draft rregulloren në shtator të vitit 2021.

Në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka aprovuar për dëgjim publik Draft Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Siç parashihet me procedurat për nxjerrjen e legjislacionit sekondar (neni 8 i Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në), KPM në pajtim me Ligjin, ka vendosur në konsultim publik draftin e rregullores nga data 27 shtator 2021 deri më 15 tetor 2021. Me kërkesë të të licencuarve të KPM-së, periudha e konsultimit është zgjatur deri më 22 tetor 2021. Të gjitha palët e interesuara kanë pasur mundësinë të japin komentet/vërejtjet e tyre me shkrim lidhur me propozim/ndryshimet në draft Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Gjatë kësaj periudhe, ishin pranuar komente nga 4 palë.

Me qëllim të vënies së draft Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-vizuele edhe një herë në dispozicion të publikut dhe palëve të interesuara, KPM ka organizuar dëgjim publik më 8 nëntor 2021. Të gjitha komentet e pranuar të cilat kanë qenë të bazuara, janë inkorporuar në draftin e rregullores.

Në mbledhjen e KPM-së, të mbajtur më 7 dhjetor 2021, Komisioni ka shqyrtuar draftin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.

Duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, pas shqyrtimit të draftit, Komisioni ka vendosur të miratojë Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale³. Me miratimin e kësaj rregullore, është shfuqizuar Rregullorja KPM-2017/02.

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

Në kuadër të takimeve të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë pjesë në takimin virtual të organizuar nga Zyra për Kritere Ekonomike dhe Treg të Brendshëm - Zyra e Kryeministrit dhe Nën-komiteti i MSA për Inovacion, Shoqëri Informative dhe Politika Sociale me 10 – 11 shkurt 2021. Takimi ishte planifikuar të mbahet në Bruksel por për shkak të situatës së pandemisë është mbajtur virtualisht.

Qëllimi i këtij takimi ishte raportimi i të arriturave por edhe i vështirësive që kanë hasur institucionet lidhur me zbatimin e obligimeve nga Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitin 2020 si dhe konkluzioneve nga takimi i Nën-komitetit nga viti i kaluar. KPM mori pjesë në diskutimin tek pjesa e Shoqërisë së Informacionit - Politika audio-vizuele dhe Media.

Përfaqësuesit e KPM-së në takim kanë paraqitur të arriturat e KPM-së gjatë vitit 2020 në përmbushjen e obligimeve që dalin nga PKZMSA si dhe vështirësitë me të cilat është përball institucioni gjatë vitit 2020, shumë prej të cilave janë si pasojë e pandemisë Covid-19. Diskutimi ishte i fokusuar në këto pika kryesore:

- përafrimi i legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audio-Vizuale 2018;
- zhvillimet lidhur me procesin e dixhitalizimit të transmetimeve tokësore;
- zhvillimet lidhur me ndryshimin e ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave;
- liri i dividendës dixhitale.

Në përfundim të takimit është ritheksuar se KPM mbetet e përkushtuar në arritjen e objektivave dhe zbatimin e obligimeve që dalin nga PKZMSA.

⁴ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20p%C3%ABr%20Ofruesit%20e%20Sh%C3%ABrbimeve%20Mediale%20Audio%20dhe%20Audiovizuele%20KPM%202021-01.pdf>

Gjithashtu, në kuadër të takimeve të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), Komisioni i Pavarur i Mediave, më 9-10 qershor 2021, ka marrë pjesë në takimin virtual të organizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Nën-komiteti i MSA për Drejtësi, Liri dhe Siguri.

Qëllimi i këtij takimi ishte raportimi i të arriturave dhe i vështirësive që kanë hasur institucionet lidhur me zbatimin e obligimeve nga Plan i Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitin 2021 si dhe konkluzioneve nga takimi i Nën-komitetit nga viti i kaluar. KPM ka marrë pjesë në diskutimin tek pika e agjendës “Liria e Shprehjes”.

Përfaqësuesit e KPM-së në takim kanë paraqitur të arriturat e KPM-së që nga raportimi i fundit në përmbushjen e obligimeve që dalin nga PKZMSA 2021, si dhe vështirësitë me të cilat është përball institucioni gjatë këtij viti, shumë prej të cilave janë si pasojë e pandemisë Covid-19.

Diskutimi ishte i fokusuar në këto pika kryesore:

- Hetimet e incidenteve të sulmeve fizike kundër gazetarëve;
- Amandamenti i Ligjit për KPM-në;
- Amandamenti i Ligjit për RTK në.

Në përfundim të takimit është ritheksuar se KPM mbetet e përkushtuar në arritjen e objektivave dhe zbatimin e obligimeve që dalin nga PKZMSA.

ANGAZHIMI DHE AKTIVITETET E KPM-SË GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE

Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme 2021 për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit. Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.
- Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM para fillimit të fushatës përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet, i cili përbëhet prej:
 1. Kapitullit I – identifikimi i reklamimit politik;
 2. Kapitullit II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
 3. Kapitullit III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Në përmbushje të këtij obligimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së nga të licencuarit, prej datës 3 deri më 14 shkurt 2021, KPM ka monitoruar performancën e 22 ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore. Në fokus të këtyre monitorimeve ishin edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, spotet politike, intervistat e debatet në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora

Faqe 31 nga 78

16:00 deri në orën 24:00. Gjatë monitorimit janë vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësira e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur si dhe pajtueshmëria me obligimet që dalin nga Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Për të gjitha rastet e shkeljeve janë ndjekur procedurat e parapara të cilat kanë rezultuar me vendime sanksionuese nga ana e Komisionit.

Publikimi i raportit të monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet nacionale 2021

Lidhur me monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme 2021 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave, më 2 mars 2021, ka publikuar “Raportin e monitorimit të Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele gjatë fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme 2021, për Kuvendin e Republikës së Kosovës”⁴.

Qëllim i monitorimit për periudhën 3 deri më 14 shkurt 2021 ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Ky raport ishte realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive dhe ka pasqyruar të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.

Raporti prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve të cilat kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmëdhjetë (14) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Opinion, TV Herc, TV Most); dhe
- Pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Zoom dhe TV Iliria) që për shkaqe teknike nuk kanë qenë në transmetim nuk ishin përfshirë në këtë monitorim.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat politike reklamuese, kronikat zgjedhore, intervistat dhe debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se prezantimi i fushatës për zgjedhjet nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele. Vlen të theksohet se gjatë periudhës zgjedhore në KPM nuk ishte adresuar asnjë ankesë nga ndonjë palë.

⁴<https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20-%20OSHMA-t%C3%AB%20gjat%C3%AB%20fushat%C3%ABs%20zgjedhore%20p%C3%ABr%20Zgjedhjet%20e%20parakoh%C3%ABshme%202021.pdf>

Përgatitjet për monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

Pas përcaktimi të datës së mbajtjes së Zgjedhjeve Lokale në Kosovë, KPM ka përgatitur dhe kishte dërguar tek të licencuarit e saj materialin e nevojshëm, përkatësisht Udhëzuesin për Zgjedhje, format e ditarëve A dhe B, si dhe Udhëzuesin për plotësim të ditarëve. Po ashtu, të njëjtat janë publikuar edhe në uebfaqen e KPM-së dhe rrjetin social të KPM (Facebook).

Organizimi i tryezave regjionale

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), i mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), nga data 13 deri më 17 shtator 2021, kishte organizuar një raund të tryezave regjionale në 5 regjione të Kosovës: në Pejë më 13 shtator 2021; në Prizren më 14 shtator 2021; në Mitrovicë më 15 shtator 2021; në Gjiilan më 16 shtator 2021 dhe në Prishtinë më 17 shtator 2021.

Qëllimi i këtyre takimeve në regjione ishte bashkëbisedimi në mes të KPM-së dhe të licencuarve për çështjet që kanë të bëjnë me përmbajtjet programore të ofruara nga Ofruesit e Shërbimit Medial Audiovizuel (OSHMA), mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe rolin e mediave në edukimin medial, si dhe vështirësitë, problemet të cilat ata i hasin gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre sidomos në periudhën e fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale.

Në këto takime ishte prezantuar rregullativa ligjore e mediave sa i përket procesit zgjedhor: pjesa e legjislacionit sipas Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje, zbatimi i të cilit është përgjegjësi e KPM-së, akteve nënligjore të KPM-së si Rregullorja 2013/03 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele, Kodi i Etikës dhe Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuele. Pas prezantimit të legjislacionit aktual, i cili rregullon funksionimin e mediave në Republikën e Kosovës, ishte prezantuar një raport përmbledhës rreth shkeljeve më të shpeshta të gjetura nga KPM gjatë monitorimit të mediave nga zgjedhjet e kaluara.

Ashtu sikur edhe herëve të kaluara, në përgatitjet për monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore, KPM ka hartuar Udhëzuesin për Zgjedhje i cili u është përcjellur mediave një javë para fillimit të fushatës zgjedhore, e i cili është një dokument përmbledhës në pika kryesore i të gjithë pjesës së legjislacionit të mediave sa i përket procesit zgjedhor.

Pikat kryesore të diskutimeve ishin përafërsisht të njëjta në të gjitha takimet regjionale, duke pasur parasysh se edhe ngecjet apo problemet e mediave të licencuara nga KPM janë kryesisht në disa pika të caktuara. Diskutimi ishte i fokusuar tek përmbajtja e komunikimeve komerciale politike gjatë fushatës zgjedhore, raportimi në mënyrë të drejtë, korrekte, objektive dhe të paanshme, përfaqësimi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme i subjekteve politike në emisione, respektimi i heshtjes zgjedhore ku ndalohet transmetimi ose publikimi i çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës (24 orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve).

Sa i përket publikimit të hulumtimeve të opinionit publik, është sqaruar se ndalohet publikimi ose transmetimi i rezultateve të hulumtimit të opinionit publik 24 orë para mbylljes zyrtare të vendotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor. Kurse si obligim tjetër i mediave në raport me KPM-në është mbajtja e ditarëve për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve

tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën subjekt politik dhe dorëzimi i tyre në KPM.

Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në media, me fokus gjatë fushatës zgjedhore por edhe jashtë saj, ishte diskutuar për sponsorizimin e programeve për fëmijë dhe vendosjen e produkteve në emisione, si një nga shkeljet e identifikuar nga KPM, koha e lejuar e transmetimit dhe mënyra e kategorizimit të programeve të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, sinjalizimi akustik dhe paralajmërimi i programit. Përveç këtyre ishte diskutuar për kujdesin që duhet t'i kushtohet dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve, të cilët janë pjesë ose janë të përfshirë në programe (pavarësisht nga çdo pajtim që jepet nga prindi ose kujdestari ligjor). Të dhënat personale për të miturit si dhe detajet të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të tyre, nuk duhet të transmetohen në rastet kur transmetimi i informacionit të tillë mund të dëmtojë mirëqenien e tyre. Ndërsa, në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHMA-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve, befasitë apo intervistat e paplanifikuara ("pritat") të fëmijëve dhe të miturve janë të ndaluara si dhe nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike. Gjithashtu, ishte diskutuar për obligimin e OSHMA-ve lidhur me ndalimin e transmetimit të intervistave apo fotografive të fëmijëve nën moshën 14 vjeç në lidhje me çështje që janë të ndërlidhura me familjet e tyre, pa pëlqimin paraprak të prindit apo kujdestarit ligjor që është përgjegjës për fëmijën.

Vazhdimi i bashkëpunimit ndërinstitutional në kuadër të procesit zgjedhor

Më 15 tetor 2021 është mbajtur konferenca e përbashkët për media nga të gjitha institucionet nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit për Procesin Zgjedhor, në lidhje me përgatitjen e institucioneve për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Konferenca është mbajtur në kuadër të Memorandumit, pjesë e të cilit janë gjashtë institucione: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Policia e Kosovës (PK), Prokurori i Shtetit (PSh); Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Përfaqësues të institucioneve përkatëse apeluan subjektet politike dhe qytetarët e Republikës së Kosovës që të respektojnë të gjitha rregullat zgjedhore që janë në fuqi, në mënyrë që të kemi një proces të lirë zgjedhor. Në këtë konferencë, Kryetari Latifi ka theksuar se KPM është duke monitoruar mediat gjatë tërë procesit zgjedhor dhe ka bërë thirrje që mediat të raportojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke shmangur shkeljet ligjore, sidomos gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

Publikimi i raporteve për monitorimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2021 në Republikën e Kosovës

Komisioni i Pavarur i Mediave, në një konferencë për media të organizuar më 2 nëntor 2021, ka publikuar "Raportin e monitorimit të Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të 17 tetor 2021"⁵.

⁵ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%C3%AB%20gjat%C3%AB%20Zgjedhjeve%20Lokale%202021.pdf>

KPM është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”. Prandaj, qëllim i monitorimit për periudhën nga data 16 shtator deri më 17 tetor 2021, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive dhe prezanton të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) OSHMA, prej të cilëve:

- Tre (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmëdhjetë (14) me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Herc, TV Most, TV Iliria); dhe
- Pesë (5) me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional, TV Zoom dhe TV Opinion, nuk janë të përfshira në monitorim, pasi që nuk kanë qenë në transmetim për shkaqe teknike.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat politike reklamuese, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Zyrtarët e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë periudhës monitoruese kanë vlerësuar: paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për subjektet politike, gjuhën e përdorur dhe në përgjithësi, pajtueshmërinë me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, Ligjin dhe aktet tjera nënligjore përkatëse të KPM-së. Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se prezantimi i fushatës për zgjedhjet nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele. Ndërsa, gjatë periudhës zgjedhore në KPM janë adresuar katër (4) ankesa.

Për të gjitha shkeljet e identifikuar gjatë periudhës zgjedhore, Komisioni ka marr vendime në pajtim me Ligjin për KPM-në.

Po ashtu, KPM ka publikuar edhe raportin e monitorimit të fushatës zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave⁶ që ka zgjatur nga data 8 deri më 12 nëntor 2021. Sërish

⁶ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%C3%AB%20gjat%C3%AB%20raundit%20t%C3%AB%20dyt%C3%AB%20t%C3%AB%20zgjedhjeve%20p%C3%ABr%20kryetar%20t%C3%AB%20komunave.pdf>

janë monitoruar të njëjtat media si në raundin e parë dhe është përdorur metodologjia e njëjtë. Gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve, KPM nuk ka pranuar asnjë ankesë.

VLERËSIMI I PËRMBAJTJEVE TË LAJMEVE QENDRORE TË OSHMA-ve

Komisioni i Pavarur i Mediave ka publikuar “Raportin e monitorimit të lajmeve qendrore”⁷, i cili është realizuar gjatë muajit korrik të vitit 2021, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e vendit.

Mostra e monitorimit ka përfshirë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) me mbulim tokësor lokal (TV DUKAGJINI); dhe
- Tri (3) që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, KLAN KOSOVA dhe TE7).

Në bazë të analizës së monitorimit, është konkluduar se në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës, kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin.

Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Në përgjithësi, raportimi nga mediat e monitoruara ka qenë neutral.

MBROJTJA E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË MEDIA

Vlerësimi i përmbajtjeve programore

Komisioni i Pavarur i Mediave në mënyrë të vazhdueshme ka treguar vëmendje të posaçme sa i përket zbatimit të akteve nënligjore të KPM-së nga ana e OSHMA-ve, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve, si kategori e ndjeshme e shoqërisë, nga përmbajtjet që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral.

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve programore të ofruara nga OSHMA-të me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, në periudha të ndryshme kohore, KPM ka kryer monitorimin e OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes OSH-ve.

⁷ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Monitorimit%20Monitorimi%20i%20lajmeve%20qendrore%20t%C3%AB%20OSHMA-ve%20korrik%202021.pdf>

Në qershor të vitit 2021, KPM ka publikuar raportin e monitorimit “Mbrotjtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”⁸, që ka përfshirë periudhën kohore shtatë (7) ditore, të zgjedhur në mënyrë rastësore nga data 22 – 28 maj 2021.

Mostra e monitorimit ka përfshirë nëntë (9) OSHMA, prej tyre:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21, KTV)
- Një (1) me mbulim tokësor lokal (TV Dukagjini); dhe
- Pesë (5) që operojnë përmes OSH-ve (RTK2, KLAN KOSOVA, KANAL 10, ATV dhe TE7).

Në mënyrë që të përcillet përputhshmëria e mediave me legjislacionin e KPM-së sa i përket mbrotjtjes së fëmijëve dhe të miturve, janë realizuar monitorime edhe në tri periudha tjera kohore, gjatë muajve:

- Korrik-gusht, me ç’rast janë monitoruar 6 OSHMA dhe në shkelje janë gjetur: TV21, TV Dukagjini, Klan Kosova dhe Kanal 10, ndërsa në pajtueshmëri kanë qenë ATV dhe TE7;
- Tetor, ku janë monitoruar 9 OSHMA dhe në shkelje janë gjetur: RTK1, KTV, TV Dukagjini, Klan Kosova dhe Kanal 10, ndërsa në pajtueshmëri kanë qenë TV21, RTK2, ATV dhe TE7; dhe
- Dhjetor, me përfshirje në monitorim të 9 OSHMA-ve, ku në shkelje janë gjetur RTK1, TV21, KTV, TV Dukagjini dhe Klan Kosova, ndërsa në pajtueshmëri kanë qenë RTK2, ATV, TE7, Kanal 10.

Ndërsa, në dhjetor të vitit 2021 është publikuar Raporti përmbledhës i II-të⁹ që ka përfshirë tri këto periudha kohore tri (3) ditore të zgjedhur në mënyrë rastësore.

Shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë monitorimeve kishin të bëjnë kryesisht me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale si: mos paralajmërimi me sinjal akustik apo tekstual para fillimit dhe pas ndërprerjeve të programeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, transmetimi i programeve të kategorive të caktuara jashtë kohës së paraparë sipas rregullores si dhe mos përdorimi i simboleve përkatëse vizuale të përcaktuara në Rregulloren për Mbrotjtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale.

⁸ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20Mbrotjtja%20e%20F%C3%ABmij%C3%ABve%20dhe%20t%C3%AB%20Miturve%20n%C3%AB%20Sh%C3%ABrbimet%20Mediale%20Audiovizuale.pdf>

⁹ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Monitorimit%20Mbrotjtja%20e%20F%C3%ABmij%C3%ABve%20dhe%20t%C3%AB%20Miturve%20n%C3%AB%20Sh%C3%ABrbimet%20Mediale%20Audiovizuale.pdf>

Për të gjitha shkeljet e evidentuara, Komisioni ka shqiptuara masa sanksionuese ndaj OSHMA-ve të gjetura në shkelje.

Pjesëmarrja e KPM-së në konferencën ndërkombëtare në Tiranë për mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive

Një delegacion i Komisionit të Pavarur të Mediave ka marr pjesë në Konferencën ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive, e cila u organizua nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në Tiranë më 12-13 tetor 2021.

Në këtë konferencë është diskutuar për mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive, standardet evropiane dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të rregullatorëve nga Evropa Juglindore: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Greqia, Turqia si dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas.

- Pjesëmarrja në këtë konferencë ishte shumë e rëndësishme për shkak të ofrimit të mundësisë së shkëmbimit të përvojave, njohjes rreth legjislacionit në vendet përkatëse dhe ato të BE-së si dhe veprimeve dhe aktiviteteve të ndërmarra nga rregullatorët sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Aktivitetet në kuadër të Edukimit Medial me fokus mbrojtën e fëmijëve në media

Me rastin e Javës Globale për Edukimin mbi Median dhe Informacionin, javë kjo që shënohet çdo vit nga UNESCO, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, më 25 tetor 2021, kanë organizuar një tryezë diskutimi me temë “Edukimi Medial/Përmbajtjet e papërshtatshme për fëmijë”.

Në tryezë ishin të pranishëm përfaqësues të Koalicionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Këshilli i Prindërve, përfaqësues të SBASHK-ut, profesorë e studentë të gazetarisë.

Në tryezë u tha që nevojitet një bashkëpunim më i afërt i rregullatorit, mediave, shkollave, këshillave të prindërve, institucioneve tjera publike si dhe OJQ-ve që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për t'i mbrojtur fëmijët nga përmbajtjet e dëmshme mediale. Prandaj, sipas pjesëmarrësve nuk është arritur ende që të hartohet një politikë në nivel vendi për edukimin medial, e cila do të adresonte sfidat e rregullimit adekuat ligjor përkatësisht amandamentimin dhe hartimin e legjislacionit krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike.

Konkluzionet e kësaj tryeze ishin:

- Inicimi i një fushate të përgjithshme vetëdijesuese për mbrojtjen e fëmijëve në media;
- Planifikimi dhe inicimi i një fushate informuese për prindërit lidhur me të drejtat e fëmijëve si dhe mbrojtjen e tyre në media;

- Realizimi i kërkesës që lënda “Edukimi për Median” të futet si lëndë obligative në kurrikulën shkollore;
- Televizioni Publik (RTK) duhet të ofrojë më shumë hapësirë programore me përmbajtje rreth edukimit medial tek pjesa për fëmijë, e me fokus të veçantë tek mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme programore;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit të aktivizohen në organizimin e punëtorive, seminareve, trajnimeve për mbrojtjen e fëmijëve në media.

Çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve kanë qenë pjesë edhe e aktiviteteve tjera që KPM ka realizuar gjatë vitit 2021 dhe janë trajtuar gjatë takimeve regjionale të realizuara nga data 13-17 shtator 2021, pastaj përmes hulumtimit “Prezantimi i fëmijëve dhe të miturve në mediat në Kosovë”¹⁰, i realizuar gjatë muajit tetor dhe nëntor të vitit 2021 në kuadër të bashkëpunimit me Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës dhe Institutin e Mediave të Kosovës (IMK), dhe mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, tryezës diskutuese të realizuar më 24 dhjetor 2021 si dhe fushatës vetëdijesuese përmes transmetimit të video spoteve.

EDUKIMI MEDIAL

Organizimi i fushatës së KPM-së për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me përmbajtjet mediale

KPM i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të edukimit medial në të gjitha segmentet e shoqërisë, ngritjen e kapaciteteve për përdorim aktiv, kritik dhe kreativ të mediave dhe ndërgjegjësimin e shikuesve dhe dëgjuesve lidhur me të drejtat e tyre dhe përdorimin e sigurt të shërbimeve mediatike.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë kanë realizuar një fushatë për angazhimin e publikut për të kontribuar në përmbajtje më të mirë në mediat audiovizuale, si edhe për të siguruar që transmetuesit të respektojnë Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

Nëpërmjet një serie prej dhjetë videosh të animuara, fushata adreson shqetësimet e publikut rreth përmbajtjes jo të duhur në mediat audiovizuale dhe inkurajon publikun që të reagojë ndaj shkeljeve duke paraqitur ankesa në KPM. Fushata po ashtu vë theksin mbi nevojën që publiku të kuptojë përmbajtjen dhe porositë e pranishme në media, të cilat mund t'i zbërthejnë me anë të shkathtësive më të mira të arritura përmes edukimit mbi mediat dhe informacionin.

Fushata përçon porosi të rëndësishme për mbrojtjen ligjore të fëmijëve dhe të të miturve, luftimin e gjuhës së urrejtjes, parandalimin e përdorimit të gjuhës fyese, promovimin e barazisë gjinore,

¹⁰ Shtojca XI e këtij Raporti

respektimin e të drejtave individuale, mbrojtjen e të drejtës së autorit, rëndësinë e edukimit mbi mediat dhe informacionin, si dhe procedurat për paraqitjen e ankesave.

Fushata është transmetuar në gjuhën shqipe në KTV dhe në gjuhën serbe TV Most deri në fund të dhjetorit 2021, ndërsa vazhdon ende në ueb faqen dhe rrjetet sociale të KPM-së¹¹.

Organizimi i tryezës së diskutimit lidhur me përfaqësimin e fëmijëve dhe përfaqësimin gjinor në media

Komisioni i Pavarur i Mediave, Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës (UP) dhe Instituti i Mediave të Kosovës (IMK), më 24 dhjetor 2021, organizuan tryezë diskutimi lidhur me përfaqësimin e fëmijëve dhe përfaqësimin gjinor në media.

Kjo tryezë diskutimi u organizua me qëllim të prezantimit të të gjeturave nga dy hulumtimet e realizuara në kuadër të bashkëpunimit të KPM-së me Departamentin e Gazetarisë, IMK-në dhe me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, të cilat ishin subjekt i diskutimit si dhe mundësi për ofrimin e pikëpamjeve dhe rekomandimeve të palëve të interesit të fushës së medias.

Pjesëmarrës në takim ishin përfaqësues nga KPM, Departamenti i Gazetarisë në UP, IMK, Save the Children, Agjencia për Barazi Gjinore, Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe OSBE-ja.

Aktivitetet në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Universitetit të Prishtinës

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të KPM-së me Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Institutit të Mediave të Kosovës (IMK), më 20 shtator 2021, është mbajtur takimi i radhës në mes përfaqësuesve të palëve të lartcekura.

Takimi kishte për qëllim inicimin dhe konkretizimin e projekteve të cilat për bazë i kanë Memorandumet e Bashkëpunimit të KPM-së me UP-në dhe IMK-në.

Me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, është arritur që të fillojë zbatimi i objektivave të memorandumit, respektivisht fillimi i praktikës për studentë të gazetarisë, të përzgjedhur nga Departamenti i Gazetarisë. Qëllimi i këtij angazhimi ishte hulumtimi dhe analizimi i përmbajtjeve programore sa i përket përfaqësimit të fëmijëve dhe përfaqësimit gjinor në media.

Ky ishte hapi i parë konkret drejt realizimit të memorandumit, sepse ka pasur shumë pengesa më herët në realizimin e aktiviteteve të përbashkta që kryesisht lidhen me situatën pandemike dhe masat e aplikueshme kundër Covid-19.

¹¹ Videot në gjuhën shqipe janë të qasshme këtu: <https://bit.ly/3GVYjfw>

Aktivitetet në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Universitetit të Prishtinës

Në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet KPM-së dhe UP/Departamenti i Gazetarisë, katër studentë kanë përfitur nga puna praktike në KPM. Faza e parë e realizimit të këtij aktiviteti është realizuar me mbështetjen e OSBE-së dhe Institutit të Mediave të Kosovës (IMK).

Studentët e përzgjedhur nga profesorët e tyre gjatë punës praktike janë angazhuar në monitorimin e përmbajtjeve programore sa i përket përfaqësimit gjinor në media dhe përfaqësimit të fëmijëve në media. Së bashku me mentorët e tyre dhe me stafin e KPM-së ata kanë përgatitur hulumtime në këto dy tema, të cilat janë publikuar gjatë një tryeze diskutimi të mbajtur më 25 dhjetor 2021.

Në hulumtimin “Monitorimi i paraqitjes së grave në debatet televizive gjatë fushatës për zgjedhjet lokale 2021”¹² është konkluduar se: “Përfaqësimi i gruas në emisionet elektorale në televizionet e monitoruara ka qenë i vogël; pjesëmarrja e numrit të grave në emisionet elektorale në televizione ka qenë simbolik; numri i grave të përfaqësuara nga subjektet politike ka qenë i vogël në raport me burrat e ftuar; në shumicën e rasteve kur gratë kanë qenë të ftuara në emisione e kanë pasur kohën e kufizuar vetëm deri në 5 minuta; në shumicën e rasteve në emisione temat si ato të shëndetësisë, drejtësisë, korrupsionit, punësimit etj, nuk kanë qenë temat kryesore që janë trajtuar nga gratë dhe ato janë ftuar vetëm në temat për të drejtat e grave e për arsimin”.

Ndërsa, në hulumtimin e dytë “Prezantimi i fëmijëve dhe të miturve në mediat në Kosovë”¹³ është konkluduar se: “Shumica e televizioneve nuk ofrojnë përmbajtje të mjaftueshme të prezantimit të fëmijëve dhe të miturve në skemën e tyre të edicioneve informative; Televizioni Publik i Kosovës (RTK1) ofron hapësirë jashtëzakonisht të kufizuar të temave që trajtojnë problemet e fëmijëve dhe të miturve; kronikat në të cilat diskutohen problemet e fëmijëve zakonisht renditen në fund të edicioneve, që nënkupton kanë relevancë më të vogël të trajtimit; kronikat e fushës së arsimit janë ato që i dominojnë kronikat për fëmijë por mbetet i lartë përdorimi i fëmijëve në kontekstin politik; në shumicën e kronikave televizive shfaqen pamjet e fëmijëve; në një pjesë të madhe të kronikave televizive shfaqet identiteti i fëmijëve; në shumicën e kronikave të monitoruara nuk ka pasur deklarata të fëmijëve”.

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave, Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj) dhe Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) dhe Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), më 9 mars 2021, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi.

¹² te vendoset linku i raportit

¹³ te vendoset linku i raportit

Memorandumi ka për qëllim përcaktimin e modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të palëve nënshkruese, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve në promovimin e barazisë gjinore në media.

KPM, ABGJ dhe QKSGJ, sipas memorandumit, do të angazhohen në realizimin e projekteve hulumtuese në temat që ndërlidhen me promovimin e barazisë gjinore në media, organizmin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve njerëzore në aspektet e promovimit të barazisë gjinore në media, organizmin e aktiviteteve vetëdijësuese, konferencave dhe tryezave të diskutimit që kanë si temë çështjen e barazisë gjinore. Gjithashtu, palët nënshkruese do të mundësojnë shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të Zyrës së KPM-së, përmes ofrimit të ekspertizës në kuadër të realizimit të projekteve të përbashkëta. Të gjitha hulumtimet dhe analizat nga projektet e përbashkëta do të publikohen dhe do të jenë shërbim të publikut dhe profesionistëve të medias.

Në kuadër të këtij Memorandumi, Komisioni i Pavarur i Mediave, Agjencia për Barazi Gjinore dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore, më 6 prill 2021, janë koordinuar me një aktivitet të përbashkët, ku përmes një letër të hapur u janë drejtuar mediave, me kërkesën që gjatë transmetimit të përmbajtjeve programore të kenë kujdes dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura me qëllim të evitimit të përmbajtjeve që promovojnë gjuhë të urrejtjes, gjuhë vulgare dhe ofenduese, si dhe nxisin ose promovojnë cilëndo nga format e diskriminimit dhe jo tolerancës, me theks të veçantë gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta ku edhe ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës mediale nga të ftuarit në emisione.

Nënshkrimi i Memorandum të Bashkëpunimit ndërmjet KPM-së dhe Fakultetit të Shkencave Politike, Departamenti i Komunikimit/Gazetarisë, Universiteti i Sarajevës

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 11 janar 2021, ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin e Sarajevës (US). Memorandumi ka për qëllim kryesor krijimin e një bashkëpunimi në mes të KPM-së dhe Departamentit të Komunikimit/Gazetarisë të Universitetit të Sarajevës (FSHP).

Gjithashtu, qëllim tjetër i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe Fakultetit të Shkencave Politike, Departamentit të Komunikimit/Gazetarisë të Universitetit të Sarajevës (FSHP), respektivisht ofrohet mundësia e realizimit të projekteve të ndryshme hulumtuese dhe analizave në temat që kanë të bëjnë me fushën e shërbimeve audiovizuale dhe organizmin e aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e shërbimeve audiovizive. KPM-ja dhe FSHP-ja do të bashkëpunojnë në aktivitete të ndryshme në fushën e shërbimeve audiovizive në përgjithësi. Është paraparë që FSHP-ja do të angazhohet në realizimin e projekteve hulumtuese duke siguruar kapacitet njerëzore, ndërsa KPM-ja do të mundësojë shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të zyrës, në kuadër të realizimit të projekteve të përbashkëta.

Si komponentë më kryesore e këtij memorandumi është se të gjitha hulumtimet dhe analizat nga projektet e përbashkëta do të publikohen që të jenë shërbim të publikut dhe profesionistëve të medias.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të KPM dhe ARKEP

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), më 17 dhjetor 2021, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi. Memorandumi ka për qëllim përcaktimin e modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të palëve nënshkruese, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve në fushat respektive që i rregullojnë palët nënshkruese.

Memorandumi synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve në funksion të menaxhimit efektiv dhe efikas të resurseve të kufizuara të spektrit frekuencor, aplikimit të neutralitetit teknologjik, sigurimit të kushteve për një konkurrencë efektive dhe mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit. Koordinimi i angazhimeve ndërinstitucionale si dhe angazhimeve dhe përpjekjeve të resurseve teknike dhe njerëzore është e nevojshme në rastet kur mandatet dhe aktivitetet e palëve ndërlidhen në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse, përkatësisht koordinimin e përbashkët të Planit Kombëtar të Radio frekuencave së bashku me Tabelën e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të Spektrit të Frekuencave për Republikën e Kosovës si dhe lirimimin dhe shfrytëzimin e frekuencave për shërbimet brezgjera (dividenta).

Gjithashtu, Memorandumi ka për qëllim promovimin e konkurrencës dhe infrastrukturës efikase në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë radio-difuzive si dhe garantimin e shërbimeve cilësore për konsumatorin, sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), Ligjin Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio difuzive Tokësore si dhe trendet e përparimeve dhe konvergjencës teknologjike.

Vazhdimi i bashkëpunimit të KPM-së me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), më 18 mars 2021, kanë zhvilluar një takim zyrtar në Tiranë. Tema kryesore e bisedimeve në mes të përfaqësuesve të delegacioneve nga dy rregullatorët audiovizivë, ishte eksperiencia në monitorimin e punës së mediave gjatë kohës kur ato mbulojnë fushatën zgjedhore. Në këtë aspekt është diskutuar për kornizën ligjore dhe nënligjore që rregullon procesin e zgjedhjeve si në Kosovë ashtu edhe Shqipëri, infrastrukturën teknologjike të monitorimit si dhe angazhimet e operatorëve të licencuar.

Duke pas parasysh zgjedhjet e mbajtura në muajin shkurt të vitit 2021 në Republikën e Kosovës, si dhe zgjedhjet që do të zhvilloheshin në prill të vitit 2021 në Shqipëri, takimi është realizuar me qëllim të shkëmbimit të përvojave më të mira të monitorimit gjatë procesit zgjedhor, me fokus jo

vetëm tek përshtatja e kornizës ligjore, por dhe tek aplikimi i masave efektive për vlerësimin në kohë sa më të shkurtër të përmbajtjeve të transmetuara gjatë fushatës zgjedhore.

Në takim është diskutuar gjithashtu edhe për procesin e dixhitalizimit të transmetimeve audiovizuale, një aspekt që prej kohësh është në agjendën e bashkëpunimit në mes të KPM-së dhe AMA-së. Një çështje tjetër që ishte diskutuar në takim ka qenë edhe dinamika e tregut audiovizuel në Kosovë dhe në Shqipëri, me fokus të veçantë nxitjen e shtimit të transmetimeve pa pagesë të kanaleve televizive.

Më 17 shtator 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave ka pritur në një vizitë pune rregullatorin homolog të mediave nga Shqipëria, Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA). Të dyja delegacionet kanë diskutuar për rrjedhën e bashkëpunimit institucional dhe mundësitë e avancimit të këtij bashkëpunimi. Temat kryesore të diskutimit ishin zhvillimet aktuale dhe puna që janë duke kryer rregullatorët, me theks të veçantë përgatitjet e KPM-së dhe fillimi i procesit të monitorimit të mënyrës se si ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) mbulojnë fushatën elektorale të zgjedhjeve lokale në Kosovë. Gjithashtu, në takim ishte diskutuar edhe për punën që po bëhet sa i përket kornizës ligjore dhe nënligjore të rregullimit të mediave në Kosovë, respektivisht në amandamentimin e disa akteve nënligjore të KPM-së. KPM dhe AMA janë pajtuar për shkëmbimin e përvojave më të mira të fazave të ndryshme të procesit të monitorimit të OSHMA-ve sidomos gjatë proceseve zgjedhore, me fokus të veçantë në vlerësimin sa më të shpejtë të përmbajtjeve të transmetuara gjatë fushatës zgjedhore.

Gjithashtu, në vazhden e këtij bashkëpunimi, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), më 10 dhjetor 2021, kanë zhvilluar një takim pune në Tiranë, ku diskutuan mbi çështje me të cilat përballen këto institucionet.

Duke pas parasysh detyrimet për implementimin e Direktivës 2018/1808 për Shërbimet Mediale Audiovizuale të BE-së, takimi në mes të AMA-së dhe KPM-së u fokusua në shkëmbimin e informacioneve për punën që duhet bërë në këtë drejtim. Direktiva 2018/1808 trajton një sërë çështjesh, të cilat kërkojnë rregullim në median audiovizuale dhe aktualisht është duke u implementuar tërësisht pothuajse nga të gjithë vendet e BE-së. Palët u dakorduan për zhvillimin e një takimi rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave në implementimin e Direktivës dhe marrjen e praktikave më të mira nga shtetet të cilat kanë avancuar në këtë drejtim.

Gjithashtu, është diskutuar rreth harmonizimit të legjislacionit, respektivisht harmonizimit të Ligjit të ri për KPM-në me Direktivën e re për AVMS dhe eksperiencat që AMA ka pasur gjatë hartimit të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe për procesin e dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radiodifuzive.

Bashkëpunimi i KPM-së me Misionin Eksplorues të Zgjedhjeve

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 24 qershor 2021, ka pritur në takim një ekip të ekspertëve në kuadër të Misionit Eksplorues të Zgjedhjeve.

Temë kryesore diskutimi në takim ishte puna dhe aktivitetet më të rëndësishme të KPM-së, në përmbushje të obligimeve kushtetuese e ligjore, me theks të veçantë për punën në monitorimin e mediave gjatë zgjedhjeve, përvoja e KPM-së në procesin e monitorimit të mediave gjatë zgjedhjeve, sfidat dhe problemet që ka hasur institucioni në këtë drejtim si dhe shkeljet e ndryshme që kanë bërë mediat dhe hapat ligjor që ka ndjekur KPM-ja për rastet e shkeljeve gjatë zgjedhjeve.

Gjithashtu, më 28 shtator 2021, Komisioni i Pavarur i Mediave ka pritur në takim pune një ekip të ekspertëve në kuadër të Rrjetit Evropian të Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve (ENEMO).

Përfaqësuesit nga ENEMO-së janë njoftuar nga rreth punës dhe aktiviteteve të KPM-së sa i përket procesit të fushatës zgjedhore për zgjedhje lokale të datës 17 tetor 2021, që janë mbajtur në Republikën e Kosovës.

Temë kryesore diskutimi në takim ishte puna dhe aktivitetet e KPM-së në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore dhe monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore.

Gjithashtu, sa i përket bashkëpunimit të KPM-së me Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së (EU EOM), gjatë gjithë kohës së fushatës zgjedhore, KPM ka zhvilluar disa takime dhe ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesin e tyre, duke ofruar bashkëpunim në kërkesat dhe pyetjet e tyre të ndërlidhur me punën dhe aktivitetet e KPM-së gjatë monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 27 maj 2021, ka pritur në vizitë Shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin z. Michael Davenport.

Temë kryesore e takimit ishte bashkëpunimi i KPM-së me OSBE-në, bashkëpunim i cili ekziston që nga themelimi i KPM-së si institucion, aktivitetet më të rëndësishme të KPM-së në përmbushje të obligimeve kushtetuese e ligjore, me theks të veçantë përkushtimin e saj në përfundimin e procesit të kalimit në transmetim dixhital dhe problemet që ka sjellë ballafaqimi me pandeminë Covid-19.

Ambasadori i OSBE-së për Kosovë z. Davenport gjatë takimit ka konfirmuar gatishmërinë e OSBE-së që bashkëpunimi do të vazhdojë dhe të avancohet më tutje. Duke vlerësuar rëndësinë e institucionit të KPM-së, Ambasadori ka shprehur përkushtimin e tij për përkrahje të vazhdueshme në zbatimin e standardeve më të larta në fushën e rregullimit të shërbimeve mediale audio-vizuele.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes për KPM-në nga misioni i OSBE-së, prej 28 - 30 qershor 2021, është organizuar një punëtori tre ditore me temën: Marrëdhëniet me media dhe ngritja e kapaciteteve të menaxhimit të mediave sociale”.

Në këtë punëtori kanë marrë pjesë zyrtarë të KPM-së, përfaqësues të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), përfaqësues nga OSBE-ja dhe ekspert të fushës së medias të angazhuar si ligjërues në punëtori. Qëllimi i kësaj punëtorie është prezantimi i zhvillimeve më të reja në fushën e mediave dhe marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Aktivitetet tjera të realizuar me mbështetje të OSBE-së kanë përfshirë edhe realizimin e videove vetëdijesuese dhe takimeve regjionale me të licencuarit e KPM-së. Në mbështetje të OSBE-së janë realizuar edhe aktivitetet e KPM-së me UP-në dhe IMK në dy hulumtimet e realizuara në vitin 2021.

Bashkëpunimi i KPM-së në kuadër të programit të BE-së dhe KE-së “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022

Me qëllim të kontributimit në të kuptuarit më të gjerë të konceptit të pluralizmit mediatik, rëndësisë institucionale dhe të lidhur me politikën si dhe rolin themelor të autoriteteve rregullatore të medias në këtë fushë, më 16 qershor 2021 është publikuar hulumtimi “Autoritetet Rregullatore të Mediave dhe Pluralizmi Medial”¹⁴. Ky hulumtim ka qenë rezultat i bashkëpunimit në mes autoriteteve rregullatorë të mediave nga Ballkani Perëndimor. Ky publikim analizon çështjen e pluralizmit të medias përmes prizmit të standardeve, kornizave legjislative dhe institucionale evropiane, praktikës ekzistuese dhe masave të propozuara drejt rritjes së diversitetit medial.

Në kuadër të programi, më 10 dhe 11 dhjetor 2021, është mbajtur trajnim dy ditor për zyrtarët e KPM-së lidhur me monitorimin e fushatave zgjedhore në shërbimet mediale audiovizuale.

Trajnimit synonte pajisjen e zyrtarëve të KPM-së, në veçanti stafit të Departamentit të Monitorimit dhe Analizave dhe Departamentit Ligjor, me njohuri dhe informacione shtesë dhe plotësuese për standardet ligjore ndërkombëtare në fushën e monitorimit të zgjedhjeve dhe mjeteve për ushtrimin e përgjegjësisë të tyre. Trajnimit ka trajtuar çështjet për shkeljen e rregullave të heshtjes zgjedhore dhe mënyrën e identifikimit të rasteve të tilla si dhe aspektet tjera politike, ligjore dhe rregullatore sa i përket heshtjes zgjedhore. Për më tepër, në mes pjesëmarrësve dhe ekspertëve të Këshillit të Evropës është diskutuar një përmbledhje e rregullave në fuqi në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shembuj konkretë se si rregullohet reklamimi me pagesë.

Ky trajnim ka trajtuar gjithashtu edhe dezinformimin dhe keqinformimin gjatë periudhës zgjedhore, çrregullimin e informacionit në mjedisin dixhital si dhe implikimet e tij në fushatat politike/zgjedhore. Ekspertët kanë shtjelluar gjithashtu ndikimin e mediave sociale dhe internetit në proceset zgjedhore dhe sfidat e monitorimit.

Konferenca regjionale e autoriteteve rregullatorë të mediave

Në kuadër të këtij programi, më 9 dhe 10 shtator 2021 në Mal të Zi, është organizuar një konferencë për rregullatorët regjional të mediave, përfshirë vendet e rajonit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Konferenca mundësoi mbajtjen e dialogut vjetor midis autoriteteve rregullatore të medias në rajon dhe mbështeti zbatimin e mëtejshëm të standardeve përkatëse evropiane në fushën e medias. Këtë vit, konferenca siguroi një platformë të hapur për diskutime të mëtejshme në lidhje me zgjedhjet, pluralizmin në media, gjuhën e urrejtjes, zhvillimet e reja në përpjekjet për të luftuar

¹⁴ <https://rm.coe.int/hf46-media-regulatory-authorities-media-pluralism-eng/1680a2df90>.

dezinformimin dhe punën e Këshillit të Evropës në këtë drejtim. U diskutuan gjithashtu modelet aktuale rregullatore evropiane për të krijuar një hapësirë dixhitale më të sigurt dhe më të hapur, si dhe ndikimin e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Kjo konferencë u lejoi rregullatorëve nga rajoni të ndajnë përvojat dhe opinionet e tyre mbi aspekte të rëndësishme që lidhen me rolin e rregullatorit kombëtar të medias, duke rritur dhe forcuar shkëmbimin e njohurive dhe përvojave ndërmjet kolegëve dhe të bien dakord për hapa të mëtejshëm dhe mbështetje reciproke drejt rritjes së lirisë së medias në rajon.

Pjesëmarrja e KPM-së në takimin vjetor të European Platform Of Regulatory Authorities (EPRA)

Më 20 dhe 21 maj 2021, është mbajtur takimi i 53-të i EPRA-së, në të cilin ka qenë pjesëmarrës edhe KPM-ja si anëtar - përfaqësues i Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij takimi vjetor janë mbajtur dy sesione plenare:

- Në sesionin e parë, përfaqësuesit e rregullatorëve janë njoftuar lidhur me të rejat nga vëzhguesit në EPRA-së, përfaqësuesit nga ERGA, projektet e EPRA-së përfshirë raportin 3 vjeçar të planit të punës. Po ashtu gjatë këtij sesioni janë zhvilluar diskutime rreth statusit të organizatës, si dhe janë zhvilluar zgjedhjet për bordin ekzekutiv, përfshirë kryetarin dhe zëvendës-kryetarin.
- Në sesionin e dytë është diskutuar rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, ndërsa përfaqësuesit e rregullatorëve janë njoftuar për iniciativat që janë ndërmarrë nga autoritetet rregullatore të mediave, anëtarë të kësaj organizate.

Pjesëmarrja në Grupet Punuese në hartim të Udhëzimeve Administrative që derivojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

KPM është përfaqësuar me një anëtar në kuadër të Grupeve Punuese në hartimin e:

- *Projekt-Udhëzimit Administrativ për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Faqet e Internetit me Përmbajtje Pornografike dhe të Atyre që Dëmtojnë Shëndetin dhe Jetën e Fëmijës; dhe*
- *Projekt-Udhëzimit Administrativ për Edukimin e Fëmijëve.*

Përfaqësuesi i KPM-së ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara në kuadër të Grupeve Punuese, duke kontribuar në ofrimin e komenteve dhe propozimeve rreth çështjeve të trajtuara në këto projekt-udhëzues administrativ.

Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Centre for Humanitarian Dialogue - CHD

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština- Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+383) (0) 38 245 031, Fax: (+383) (0) 38 245 034, E-mail: Info@kpm-ks.org; www.kpm-ks.org

Në këtë takim ishte diskutuar mundësia për bashkëpunim në të ardhmen në projekte të përbashkëta në mes të KPM-së dhe CHD-së, me fokus tek monitorimi i mediave gjatë mbulimit të fushatave

Faqe 47 nga 78

zgjedhore. Tema kryesore e diskutimit në këtë takim ishte rreth aktiviteteve që janë duke i zhvilluar në lidhje me fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale. Në takim u shqyrtuan mundësitë e tjera për bashkëpunim në mes të palëve, në aktivitete në interes të përbashkët në fushën e mediave.

Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Advocacy Training and Resource Center ATRC

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 13 korrik 2021, ka zhvilluar një takim pune me organizatën Advocacy Training and Resource Center – ATRC. Në këtë takim ishte diskutuar dhe shqyrtuar mundësia për bashkëpunim në të ardhmen në projekte të përbashkëta, kryesisht sa i përket përdorimit të gjuhës së urrejtjes në media.

Kjo çështje ka mbetur të përcaktohet në mes palëve përmes projekteve konkrete në këtë aspekt.

Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Save the Children

Komisioni i Pavarur i Mediave ka zhvilluar disa takime pune me organizatën Save the Children, në të cilat është diskutuar mundësia për bashkëpunim në të ardhmen në projekte të përbashkëta, me fokus tek mbrojtja e fëmijëve në media. Temë kryesore e diskutimit në këto takime ishte amandamentimi i kornizës nënligjore të KPM-së, tek pjesa për mbrojtjen e fëmijëve në media konform Ligjit 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, respektivisht obligimet ligjore që dalin nga ky ligj në raport me KPM-në.

Bashkëpunimi i KPM-së me organizatën Demokracia për Zhvillim

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 27 shtator 2021, ka zhvilluar një takim pune me përfaqësues të Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe organizatës Demokracia për Zhvillim (D4D). Në këtë takim ishte diskutuar mundësia për bashkëpunim në të ardhmen në projekte të përbashkëta, përkatësisht lidhur me draft konceptin e projektit për luftimin e lajmeve të rreme dhe dezinformimin. Përfaqësuesit e KPM-së kanë falënderuar Ambasadën Zvicerane për gatishmërinë e tyre për të mbështetur aktivitetet e institucionit përmes D4D, duke theksuar nevojën që ka rregullatori për mbështetje teknike e financiare në adresimin e shumë çështjeve me interes të publikut.

KPM ka shprehur gatishmërinë institucionale që në kuadër të mandatit ligjor, të ofrohet kontributi i saj në të gjitha aktivitetet e përbashkëta që do të mund të realizohen në të ardhmen.

Pjesëmarrja e KPM-së në Asamblenë e 21-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullative - MNRA

Një delegacion i Komisionit të Pavarur të Mediave ka marrë pjesë në Asamblenë e 21-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullative - MNRA, që kishte zhvilluar punimet në Cavtat/Dubrovnik, nga data 10 deri më 12 tetor 2021.

Në këtë takim është diskutuar për politikën e BE-së për mediat, rolin e rregullatorëve në rregullimin e përmbajtjes në platformat online, gratë dhe mediat, edukimin medial, imigrimin dhe racizmin si dhe ndikimin e pandemisë në mediat audiovizuale.

Takimi ishte një mundësi e mirë që delegacioni nga Kosova të njihet me përvojat e rregullatorëve tjerë në transpozimin e direktivës së BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale në legjislacionin e tyre, teksa në proces është transpozimi i kësaj direktive edhe në Ligjin e KPM-së.

Konferenca regjionale “Mbështetja teknike për mediat e shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor”

Në kuadër të projektit “Mbështetja teknike për mediat e shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor” (Technical Assistance to Public Service Media in the Eastern Balkans - PSMĖB), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga konzorciumi i udhëhequr nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, më 23 dhe 24 shtator 2021 në Beograd, është organizuar punëtorja regjionale “Përdorimi i mjeteve moderne të matjes së audiencës (shikueshmërisë)”.

Pjesëmarrës në këtë punëtori kanë qenë përfaqësues të autoriteteve rregullatore të mediave dhe të transmetuesve të shërbyesve publik (TV publike) të regjionit.

Gjatë kësaj punëtorie janë bërë prezantime nga ekspertë të kompanive të specializuara për matje të audiencës, përfshirë Nielsen Admosphere (Çeki), Nielsen (Zvicër), rreth rolit të matjes së shikueshmërisë dhe metodave të përdorura në disa vende të BE-së, por edhe në vendet tjera në të cilat operon kjo kompani. Ekspertët kanë prezantuar punën e tyre me mjetet reale ekzistuese së matjes së audiencës, duke përfshirë sistemin e analizës së nivelit të të anketuarve, kapacitetet e përgjithshme, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga të anketuarit, metodat e avancuara të analizës, si dhe elementet bazike të matjes: si target grupet, platformat, në kohë reale/apo në kohë të kaluar, në transmetim tokësor apo online, kufizimet e sistemit të raportimit, përdorimin e return path data (të dhënat që grumbullohet nga të anketuarit se çfarë kanë shikuar, përmes set-up-box, të cilat pastaj përpunohen nga këto kompani) për matje të audiencës dhe përpunimin e tyre.

Po ashtu, ekspertët kanë elaboruar edhe për mangësitë gjatë matjeve të audiencës, që kryesisht ndërlidhen me kufizimet në rastet e mos mbulimit të tërësishëm të tregut, pasi që në matje nuk përfshihen kompani të huaja (nga vendet jashtë Evropës) si Youtube, Netflix etj. Ndërsa, nga ekspertë të kësaj fushe, është bërë prezantim edhe nga përfaqësues të ZDF (televizion gjerman), të cilët kanë prezantuar sistemin e brendshëm të raportimit, përkatësisht matjes së shikueshmërisë së këtij televizioni në raport me kanalet tjera gjermane.

Në kuadër të këtij projekti, më 16 nëntor 2021, në Podgoricë është mbajtur edhe Konferenca Regjionale “*Ndarja e pushteteve ndërmjet organeve qeverisëse/mbikëqyrëse dhe menaxhmentit të mediave të shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor*”, e organizuar me qëllim të diskutimit të marrëdhënieve ndërmjet mediave të shërbimit publik dhe organeve qeverisëse në kontekstin e standardeve të Këshillit të Evropës (KE) dhe Parimeve të Përbashkëta mbi Qeverisjen e Mediave të Shërbimit Publik në Ballkanin Perëndimor.

Pjesëmarrës në këtë konferencë kanë qenë përfaqësues nga mediat e shërbimit publik, autoritetet rregullatore të mediave, parlamentet, shoqëria civile, përfshirë shtetet si: Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, si dhe përfaqësues të BE-së, KE-së dhe EBU-së.

Ndërsa, më 17 nëntor 2021, është mbajtur Takimi i komitetit drejtues të këtij projekti, gjatë së cilës janë prezantuar aktivitetet e realizuara nga viti 2018-2021 dhe planifikimet për aktivitetet e mbetura deri më korrik të vitit 2022. Pjesëmarrësit kanë paraqitur vlerësimet e tyre lidhur me

aktivitetet e realizuar si dhe kanë ofruar komentet dhe pikëpamjet lidhur me aktivitetet e planifikuara.

Organizmi i takimit me përfaqësuesit e operatorëve të shpërndarjes dhe atyre të VAPIK

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 7 tetor 2021, ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e Operatorëve të Shpërndarjes dhe atyre të VAPIK në lidhje me regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e autorit. Në kuadër të atij takimi është diskutuar në lidhje me regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e autorit nga operatorët e shpërndarjes në shoqatën VAPIK.

Përfaqësuesit e operatorëve janë pajtuar për zbatimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit, mirëpo nuk janë pajtuar në lidhje me lartësinë e tarifave të cilat duhet t'i paguajnë shoqatës VAPIK.

Ndërsa, Shoqata VAPIK kishte kërkuar përsëri të zbatohet Ligji dhe Vendimi i Qeverisë sa më shpejt, duke bërë regjistrimin e marrëveshjeve sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e autorëve dhe prodhuesve. Shoqata VAPIK gjithashtu kishte kërkuar nga KPM-ja që t'i pranojë vetëm marrëveshjet të cilat janë të regjistruara në VAPIK. Si përfundim i këtij takimi, palët janë dakorduar që të organizojnë një takim me Ministrinë e Kulturës, për të diskutuar për çmimin e tarifave dhe uljen e tyre. Deri në fund të periudhës raportuese, nuk ishte arritur të organizohej një takim i tillë.

Luftimi i piraterisë në fushën audiovizuale

Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur takime me përfaqësues të Policisë së Krimeve Kibernetike, ARKEP dhe operatorëve të shpërndarjes, në lidhje me luftimin e piraterisë në fushën audiovizuale.

Qëllimi i takimeve ka qenë koordinimi ndërinstitutional në luftimin e piraterisë, sipas kompetencave që kanë institucionet respektive, duke marrë parasysh edhe kompleksitetin e luftimit të kësaj dukurie (për shkak të zhvillimeve të hovshme teknologjike).

Si përfundim është shqyrtuar mundësia që me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit në të ardhmen, të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi ndërinstitutional, për të adresuar të gjitha kërkesat dhe nevojat specifike që kanë të bëjnë me luftimin e piraterisë online në fushën audiovizuale.

Hartim i Draft Planit Strategjik trevjeçar

Gjatë vitit 2021, KPM ka krijuar Grupin Punues për hartimin e Draft Planit Strategjik trevjeçar të punës së KPM-së. Qëllimi i këtij Grupi Punues është hartimi i një plani të aktiviteteve për periudhën e ardhshme trevjeçare dhe realizimin e objektivave në raport me zhvillimin e KPM-së,

përsa i përket avancimit të kornizës ligjore dhe aspekteve tjera zhvillimore. Puna në këtë dokument është në zhvillim e sipër dhe planifikohet që ky dokument të miratohet gjatë vitit 2022.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive, si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur.

Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, përcaktohet që Kryeshefi Ekzekutiv:

- menaxhon me nëpunësit civilë të KPM-së;
- menaxhon me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikën e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive; dhe
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë katër (4) departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës:

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
- Departamenti i Licencimit;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor; dhe
- Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 39 pozita deri në vitin 2020. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, proces ky që është filluar gjatë vitit 2018, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër të zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendit në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), gjatë vitit 2021, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe aktet nënligjore të KPM-së, ndërsa gjatë periudhës së zgjedhjeve, përfshirë ato lokale dhe të përgjithshme, është vlerësuar pajtueshmëria e tyre në bazë të dispozitave ligjore të parapara në Ligjin për Zgjedhjet.

Rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra dhe realizimit të aktiviteteve të poshtëshënuara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të Zyrës Ekzekutive të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme.

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele

Qëllimi i monitorimit të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele.

Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu: Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele, KKPM-2016/03 Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele.

Lidhur me këtë, DMA ka realizuar monitorimin e përmbajtjeve programore në periodha të ndryshme kohore gjatë vitit 2021.

Monitorimi ishte fokusuar në vlerësimin dhe analizimin e programeve me përmbajtje të dëmshme, që sipas akteve nënligjore në mes tjerash i referohen programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve, kohën e transmetimit të përmbajtjeve të tilla programore, paralajmërimit dhe përdorimit të shenjave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele.

Gjithashtu, fokus i monitorimit ka qenë edhe gjuha e përdorur në përmbajtje programore, rastet kur fëmijët apo të miturit kanë qenë të përfshirë apo prezentë në përmbajtje të caktuara programore, përmbajtjet e komunikimeve komerciale audiovizuele në raport me fëmijët dhe të miturit dhe format e komunikimeve komerciale në programet për fëmijë.

Mosta e monitorimit është zgjedhur në mënyrë rastësore, që ka përfshirë periudhën kohore shtatë (7) ditore, nga data 22 – 28 maj 2021, dhe periudhën kohore tri (3) ditore, gjatë muajit korrik-gusht, tetor dhe dhjetor të vitit 2021.

Në monitorim janë përfshirë nëntë (9) OSHMA me status të ndryshëm të licencës dhe me përmbajtje programore gjeneralistike:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional (RTK 1, KTV, TV 21)
- Një (1) OSHMA me transmetim tokësor lokal (TV Dukagjini)
- Pesë (5) OSHMA-të që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova, ATV, TE7, Kanal 10).

Të gjeturat nga monitorimi janë përmbledhur në dy raportet e publikuara në shtojcën VI, VIII dhe IX.

Mediat gjatë zgjedhjeve

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII

të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili vlen edhe për Zgjedhjet Lokale.

Gjatë vitit 2021, në Republikën e Kosovës janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme më 14 shkurt 2021, dhe ato lokale më 17 tetor 2021 dhe 14 nëntor 2021.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, para fillimit të fushatave zgjedhore, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, i cili është një interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje. Po ashtu, më 26 janar 2021¹⁵, më 07 shtator 2021¹⁶, më 1 nëntor 2021¹⁷, të licencuarit janë njoftuar edhe përmes ueb faqes së KPM-së lidhur me obligimet ligjore të tyre gjatë zgjedhjeve.

Gjatë periudhës së zgjedhjeve të përgjithshme dhe atyre lokale, është realizuar monitorimi i OSHMA-ve me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me Kreun VIII të Ligjit të Zgjedhje, përfshirë Udhëzuesin e KPM-së për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

Fokus i monitorimit ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, spotet politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Gjatë periudhës monitoruese është vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur dhe në përgjithësi pajtueshmëria me Udhëzuesin e KPM-së për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme, monitorimi ka përfshirë periudhën kohore prej 3 deri më 14 shkurt 2021¹⁸, ndërsa gjatë zgjedhjeve lokale është realizuar për periudhën nga data 16 shtator deri më 17 tetor 2021¹⁹ gjatë raundit të parë, përkatësisht 8 nëntor 2021 deri më 14 nëntor 2021²⁰ në raundin e dytë.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);

¹⁵ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3286

¹⁶ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3387

¹⁷ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3420

¹⁸ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20-%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20C3%AB%20fushat%20C3%ABs%20zgjedhore%20p%20C3%ABr%20Zgjedhjet%20e%20parakoh%20C3%ABshme%202021.pdf> ose shtojca V Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

¹⁹ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20C3%AB%20Zgjedhjeve%20Lokale%202021.pdf> ose shtojca xxxx Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

²⁰ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20C3%AB%20raundit%20t%20C3%AB%20dyt%20C3%AB%20t%20C3%AB%20Zgjedhjeve%20p%20C3%ABr%20Kryetar%20t%20C3%AB%20komunave.pdf> ose shtojca VI Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës së Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave

- Katërmbëdhjetë (14) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Opinion, TV Herc, TV Most); dhe
- Pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Përmes njoftimeve për media gjatë tërë fushatave zgjedhore, KPM ka kërkuar nga të licencuarit të veprojnë në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm gjatë procesit zgjedhor, duke ftuar të licencuarit të kontribuojnë me profesionalizëm në mbulimin e procesit zgjedhor. Gjithashtu, përfaqësuesit e KPM-së kanë dhënë intervista në disa OSHMA me qëllim të ofrimit të sqarimeve të detajuara sa i përket raportimit gjatë periudhës së zgjedhjeve në përgjithësi, e në veçanti gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve²¹

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është realizuar monitorimi i lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e KPM-së, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e Kosovës.

Vlerësimi dhe monitorimi i përmbajtjeve të edicioneve qendrore të lajmeve është bërë për periudhën kohore një (1) muaj, duke përfshirë muajin korrik të vitit 2021. Mostra e monitorimit ka përfshirë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor lokal (TV Dukagjini); dhe
- Tre (3) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova dhe TE7).

Përmbajtja e monitoruar është ndarë sipas kategorive/temave dhe nënkategorive nga fusha të ndryshme shoqërore. Monitorimi është fokusuar në vlerësimin e relevancës së lajmeve, saktësinë, mbulimin e balancuar, mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimit, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve. Raportin e plotë mund ta gjeni në shtojcën V.

Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Vlerësimi i pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale ka qenë pjesë e aktiviteteve të monitorimit të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve lidhur me pajtueshmërinë me aktet nënligjore të KPM-së. Gjatë monitorimit të periudhës së zgjedhjeve të

²¹ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Monitorimit%20Monitorimi%20i%20lajmeve%20qendrore%20t%C3%AB%20OSHMA-ve%20korrik%202021.pdf> ose shtojca V “Raport Monitorimi “Monitorimi i Lajmeve Qendrore të OSHMA-ve”

përgjithshme²² dhe atyre lokale²³²⁴, është bërë edhe vlerësimi i OSHMA-ve sa i përket formave të komunikimeve komerciale si reklamimi me ekran të ndarë (neni 12), sponsorizimi (neni 14) dhe vendosja e produktit në lajme dhe programe të çështjeve aktuale / debate zgjedhore (neni 15). Ndërsa, gjatë monitorimit të OSHMA lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në përmbajtjet programore²⁵²⁶, monitorimi është fokusuar edhe në dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve të përcaktuara në Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, përfshirë përmbajtjen e komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet dhe shërbimet e reklamuar, si dhe ndikimit të tyre tek fëmijët dhe të miturit (sipas nenit 9 dhe nenit 16), orarin e transmetimit të KKAV-ve dhe teleshoppingut për produkte të caktuara (sipas nenit 10), vlerësimi nëse në programe për fëmijë janë përdorur format e komunikimeve komerciale si reklamimi me ekran të ndarë, telepromocioni dhe reklamimi virtual (sipas nenit 12), sponsorizimi (sipas nenit 14) dhe vendosja e produkteve (sipas nenit 15).

Raporti gjinor

Në kuadër të aktiviteteve të monitorimit të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve lidhur me pajtueshmërinë me aktet nënligjore të KPM-së, nga të dhënat e grumbulluara janë nxjerr edhe të dhëna sa i përket raportit gjinor në OSHMA.

Gjatë monitorimit të edicioneve qendrore të lajmeve²⁷ të transmetuara gjatë muajit korrik 2021, sa i përket raportit gjinor, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket numrit të moderimit/udhëheqjes dhe editimit/redaktimit të lajmeve në bazë të gjinisë si dhe hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit sipas gjinisë. Raporti gjinor është matur edhe në prezantimin e tri kronikave të para të edicioneve qendrore, përkatësisht nëse ato janë prezantuar nga gazetarë femra apo meshkuj.

Ndërsa, gjatë monitorimit të periudhës së fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme²⁸ dhe zgjedhjeve lokale, gjatë raundit të parë²⁹ dhe raundit të dytë³⁰, janë nxjerr edhe të dhënat sa i përket përfaqësimit gjinor në debate dhe intervista të përfaqësuesve të SPC-ve garuese, të cilat janë prezantuar në raportet e monitorimit gjatë zgjedhjeve.

²² <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20-%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20fushat%20C3%ABs%20zgjedhore%20p%20C3%ABr%20Zgjedhjet%20e%20parakoh%20C3%ABshme%202021.pdf>

²³ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20Zgjedhjeve%20Lokale%202021.pdf>

²⁴ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20OSHMA-t%20C3%AB%20gjat%20raundit%20t%20C3%AB%20dyt%20C3%AB%20t%20C3%AB%20zgjedhjeve%20p%20C3%ABr%20kryetar%20t%20C3%AB%20komunave.pdf>

²⁵ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20Monitorimi%20Mbrojtja%20e%20F%20C3%ABmij%20C3%ABve%20dhe%20t%20C3%AB%20Miturve%20>

²⁶ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20i%20Monitorimit%20Mbrojtja%20e%20F%20C3%ABmij%20C3%ABve%20dhe%20t%20C3%AB%20Miturve%20n%20Sh%20C3%ABrbimet%20Mediale%20Audiovizuale.pdf>

²⁷ Të dhënat lidhur me raportin gjinor në shtojcën V Raport Monitorimi “Monitorimi i Lajmeve Qendrore të OSHMA-ve”

²⁸ shtojca VI Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

²⁹ shtojca VIII Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

³⁰ shtojca IX Raport Monitorimi OSHMA-të gjatë Fushatës së Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave

Mbulimi i situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore

Gjatë monitorimit të edicioneve qendrore të lajmeve³¹ të transmetuara gjatë muajit korrik 2021, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket mbulueshmërisë së situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore. Gjatë kësaj periudhe është matur hapësira e dhënë në kronikat që kanë trajtuar temën e COVID19, e ndërlidhur me fusha të caktuara dhe ndikimit në to.

Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë

Në fillim të vitit 2021, ofruesve të shpërndarjes u është kërkuar të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve, marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit të këtyre kanaleve dhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet janë siguruar të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të operatorëve të shpërndarjes si dhe oferta e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2021, janë kryer edhe monitorime të ndryshme në terren, në bazë të ankesave dhe ex-officio, lidhur me pajtueshmërinë e operatorëve të shpërndarjes me aktet nënligjore të KPM-së, si dhe rastet e operimeve ilegale pa licencë të KPM-së.

Monitorimet janë realizuar me qëllim të verifikimit të kanaleve të ritransmetuara nga OSH-të, verifikimin e obligimeve të tyre ngaj përdoruesve në lidhje me ri-programimin e renditjes numerike të kanaleve, grupimit dhe kontrollit prindëror të kanaleve përmes pranuesve të shërbimit.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të Operatorëve të Shpërndarjes janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm tek Departamenti Ligjor.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale dhe operatorë të shpërndarjes, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve të licencës së KPM-së.

Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së i cili, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në, është në dispozicion të publikut.

Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara dhe ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit:

Të licencuara 19 TV stacione:

- 1 TV stacion publik;
- 13 TV stacione në gjuhën shqipe;

³¹ Të dhënat lidhur me mbulimin e situatës pandemike në shtojcën V Raport Monitorimi "Monitorimi i Lajmeve Qendrore të OSHMA-ve"

- 5 TV stacione në gjuhën serbe;

Të licencuara 89 Radio stacione:

- 2 radio stacione të transmetuesit publik;
- 57 radio stacione në gjuhën shqipe;
- 22 radio stacione në gjuhën serbe;
- 3 radio stacione në gjuhën boshnjake;
- 1 radio stacione në gjuhën turke;
- 2 radio stacione në gjuhën gorane;
- 1 radio stacione në gjuhën rome;
- 1 radio stacione multietnike.

Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara dhe ndarja e tyre sipas kategorisë së mbulimit

Të licencuara 19 TV stacione:

- 3 TV nacionale
- 19 TV lokale/regjionale

Të licencuara 89 Radio stacione:

- 4 radio nacionale
- 20 radio regjionale
- 62 radio lokale dhe
- 3 radio me fuqi të ulët transmetimi.

Numri Operatorëve të Shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale (OSH) të licencuar dhe ndarja e tyre sipas pronësisë:

Të licencuar 36 operatorë të shpërndarjes:

- 29 operatorë të shpërndarjes me pronarë shqiptar;
- 5 operatorë të shpërndarjes me pronarë serb;
- 2 operatorë të shpërndarjes me pronarë boshnjak/goran;

Numri i Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Adio dhe adiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes dhe ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit:

Të licencuar 115 Ofrues të Shërbimeve Mediale Adio dhe Adiovizuale:

- 104 OSHMA transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 8 OSHMA transmetojë program në gjuhën serbe;
- 3 OSHMA transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).

Numri i kërkesave të proceduara

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Licencimit ka regjistruar 57 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, njoftime për heqje dorë nga licenca, kërkesa për ndryshim të skemës programore si dhe raste të tjera që lidhen me kushtet dhe termet e përgjithshme dhe ato teknike të licencës së KPM-së.

Departamenti i Licencimit ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2021, KPM ka marrë këto vendime për licencimin e OSHMA-ve dhe OSH-ve si dhe vendime lidhur me ndryshimin e kushteve të licencës:

22 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;

- 1 vendime për licencimin e një Operatorit të Shpërndarjes;
- 1 vendim për refuzimin e kërkesës për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes;
- 6 vendime për ndërprerje të licencës si rezultat i heqjes dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së për Operator të Shpërndarjes;
- 10 vendime për ndryshim të pronësisë (në 3 nga vendimet, përveç pronësisë, është ndryshuar edhe emri dhe skema programore e të licencuarit);
- 2 vendime lidhur me refuzimin e kërkesës për ndryshim të pronësisë;
- 3 vendime për ndryshimin e ermit të licencuarve;
- 1 vendim për ndryshimin e zonës së mbulimit; dhe
- 1 vendim për frekuenca shtesë për transmetuesin publik (Radio Kosova 1 dhe 2).

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2021, ato të bartura tek Departamenti Ligjor dhe rastet e mbyllura pa nevojë për vendim të Komisionit.

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Licencimi ka trajtuar edhe 10 raste, prej tyre:

- 6 raste janë bartur për shqyrtim në vitin 2022
- 1 rast është bartur për trajtim nga Departamenti Ligjor;
- 3 raste janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit (pasi që të licencuarit kanë ardhur në pajtueshmëri me kushtet e licencës së tyre).

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2021, ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) dhe Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizikë dhe juridikë të parashtruara kundër OSHMA-ve dhe OSH-ve.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së³² janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal - Shkelje e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 të KPM-së

Gjatë vitit 2021, Departamenti Ligjor ka proceduar dymbëdhjetë (12) raste për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje Operatorëve të Shpërndarjes: Media Link, Ylber Hoxha, Val Net, Elcom F, Kiki Net, Speed Net, Kamenica Net, Net Plus D.O.O, TV Net, Cipko Net, Niart dhe Sky Net, për operim ilegal. Katër prej këtyre operatorëve: Net Plus D.O.O, TV Net, Cipko Net dhe Niart kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri për t’u pajisur me licencë të KPM-së. Këto raste barten për vitin 2022.

Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar shtatëdhjetë (70) raste për mos sjellje të raportit vjetor. Të gjithë të licencuarve të cilët kanë dështuar të veprojnë në pajtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së u janë dërguar Njoftime për shkelje, si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor, dyzet e dy (42) nga këto OSHMA kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Ndërsa, për njëzet e tetë (28) OSHMA tjera Komisioni i KPM-së ka marrë Vendime, nëntë (9) prej tyre me masë sanksionuese në shumën prej një mijë (1000) euro, ndërsa nëntëmbëdhjetë (19) tjera me masë sanksionuese Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar dy (2) raste kundër OSHMA-ve që janë gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale, TV Vali dhe TE 7, të cilat kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. TE 7 pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor ka ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për TV Vali, Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim me masë sanksionuese Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

³² Shih Shtojcën II “Paraqitja Tabelare e rasteve ligjore”

Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM- 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar dhjetë (10) raste kundër OSHMA-ve lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Këto OSHMA kanë pranuar Njoftimin për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas pranimit të Njoftimeve për shkelje, gjashtë (6) prej këtyre OSHMA kanë ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për katër (4) prej tyre Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim me masë sanksionuese Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar dy (2) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. TV Syri Vision ka pranuar shkresë, ndërsa RTK 1 ka pranuar Njoftim për shkelje si veprim i parë procedural dhe të dy kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

Rastet për zbatimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar tridhjetë e katër (34) raste lidhur zbatimin e këtij Ligji dhe për këtë KPM iu ka dërguar shkresë operatorëve të shpërndarjes lidhur regjistrimin e marrëveshjeve në shoqatën Vapik ashtu siç përcaktohet me nenin 30.2 të Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Nga këto raste, tridhjetë (30) barten për vitin 2022 për arsye të mos zbatimit të Ligjit nga ana e OSH-ve lidhur me regjistrimin e marrëveshjeve në shoqatat kolektive, ndërsa katër (4) tjera kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 i ka dërguar në përmbardim nëntëdhjetë e një (91) Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilët nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2021. Po ashtu, në përmbardim janë dërguar edhe njëzet e pesë (25) raste për mos pagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.

Rastet për shkeljen Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2021 ka proceduar pesëdhjetë e katër (54) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH).

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje atyre që janë gjetur në shkelje, dhe të tjerëve Përgjigje në ankesa pas konstatimit nga KPM se nuk kanë vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2020/01.

Departamenti Ligjor i ka rekomanduar tek Komisioni vetëm pesë (5) raste të OSH-ve, për katër (4) prej tyre Komisioni ka marrë Vendim që t'ua refuzojë Ankesat si të pabazuara, ndërsa një (1) rast ndaj Kujtesa Net është sanksionuar me Vërejtje. Të gjitha këto raste janë mbyllur.

Ankesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2021, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Janë proceduar shtatëmbëdhjetë (17) raste:

1. Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Lul Raka ndaj Radio Kosova 1. Ankesa i referohet emisionit “Metropol” i transmetuar në Radio Kosova 1, me pretendimin se moderatori i emisionit ka deklaruar se në kohë pandemie disa infektologë kanë rrëshqit, duke cekur se z. Lul Raka ka thënë se pandemia e ka zhveshë nudo sistemin shëndetësor. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Radio Kosova 1 i ka kërkuar falje publike z. Raka në emisionin e njëjtë dhe për këtë ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 21 prill 2021. Rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në Ankesën e RTK 1 ndaj TV Dukagjinit. Ankesa i referohet emisionit Kallxo Përnime me titull “Çka po ndodh në RTK”, të transmetuar në TV Dukagjini, me pretendimin se moderatorja e emisionit i referohet Bordit që ka lejuar punësime me ramje të lirë, shprehje kjo denigruese. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini duhet dhënë Palës ankuese mundësinë të deklarohet sipas nenit 6.2 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar shkresë me datën 26 mars 2021. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 12 prill 2021 më të cilën e ka udhëzuar se mund ta ushtrojë të drejtën e reagimit në afat prej 7 ditësh. Rasti është mbyllur.
3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Albert Zogiani dhe z. Smajl Krasniqi ndaj TV Dukagjinit. Ankesa i referohet emisionit Kallxo Përnime me titull “Misteret e vrasjes” të transmetuar në TV Dukagjini. Palët ankuese kanë bërë ankesë me pretendimin se TV Dukagjini, konkretisht gazetari ka shkelur Kodin Etik për shkak të qasjes së njëanshme dhe të pa balancuar, mungesë të saktësisë së lajmit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të nenit 6.1 dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 20 prill 2021, ku pas njoftimi TV Dukagjini ia ka ofruar Palës ankuese mundësinë e deklarimit lidhur me emisionin në fjalë dhe për këtë TV Dukagjini ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 25 maj 2021. Rasti është mbyllur.

4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Kadrije Asllani ndaj Kanal 10. Ankesa i referohet kronikës të transmetuar në emisionin “Mëngjesi me Arbenin” të transmetuar në Kanal 10. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Kanal 10 gjatë transmetimi të emisionit ka transmetuar pamje të një fëmije me sindrom Down pa pëlqimin e prindit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Kanal 10 ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës pasi që fëmija është shfaqur me autorizim të prindit, ku më pas edhe është hijezuar fytyra e të miturit. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 15 prill 2021. Rasti është mbyllur.
5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Gëzim Sfeçla ndaj TE 7. Ankesa i referohet një kronike të lajmeve qendrore të transmetuar në TE 7. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se TE 7 ka transmetuar të pavërteta rreth punësimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë duke cekur se Qeveria Kurti e ka rehatuar si i afërt me ministrin e Punëve të Brendshme. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe bazuar në Raport të monitorimit ka gjetur se TE 7 i ka kërkuar falje publike z. Sfeçla si dhe ia transmetuar reagimin tij, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 28 maj 2021. Rasti është mbyllur.
6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Ervehe Gashi ndaj TV Dukagjinit. Ankesa i referohet emisionit Kallxo Përnime me titull “Pazaret me hetime” të transmetuar në TV Dukagjini, me pretendimin se me transmetimin e këtij emisioni i është cenuar rëndë dinjiteti dhe integriteti personal dhe profesional. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës. Komisioni më datën 26 maj 2021 ka marr Vendim që Palës ankuese t’ia refuzojë ankesën si të pabazuar dhe e ka udhëzuar ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10.1 të Kodit të Etikës. Pala ankuese me datën 26 qershor 2021 ka bërë ankesë në Bordin për Ankesa kundër Vendimit të Komisionit. Më datën 21 korrik 2021 Bordi për ankesa e ka njoftuar Palën ankuese se Bordi nuk është në përbërje të plotë dhe se mund të vazhdojë procedurat ligjore tutje bazuar në legjislacionin në fuqi. Rasti është mbyllur.
7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në Ankesën e Komunës së Drenasit ndaj KTV-së. Ankesa i referohet kronikës me titull “Mashtrimi gjatë ndërrimit të shfrytëzuesit të një prone komunale në Drenas” të transmetuar në lajmet qendrore në KTV. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se KTV nuk ka bërë balancim të lajmit dhe se nuk ka kontaktuar personat përgjegjës të Komunës së Drenasit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të nenit 6.2 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje më datën 28 qershor 2021, duke kërkuar që t’i jepet e drejta e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh. Pas disa procedurave dhe analizimit të detajuar të rastit KPM ka gjetur se KTV ka përmbushur kriteret e parapara për të vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 12 nëntor 2021. Rasti është mbyllur.

8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Sali Shkupolli ndaj ATV-së. Ankesa i referohet një transmetimi direkt të emisionit “Studio A” lidhur me ekspozitën “Frymë” të Sali Shkupollit, e transmetuar në ATV. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se gjatë fundit të bisedës së transmetimi të emisionit live mes moderatores dhe gazetares është bërë shaka me punimet në mënyrë ironike. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se ATV nuk ka vepruar në kundërshtim me Ligjin apo aktet nënligjore të KPM-së. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 28 qershor 2021. Rasti është mbyllur.
9. Rasti i nëntë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Butrina Burniku ndaj ATV-së. Ankesa i referohet emisionit “N`nej” lidhur me kronikën “Dëshira që të bëhet nuse mbeti ëndërr e pa realizuar për Baftijen” e transmetuar në ATV. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se transmetimi i këtij emisioni i ka paraqitur familje me kushte të vështira ekonomike. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se ATV nuk ka vepruar në kundërshtim me Ligjin apo aktet nënligjore të KPM-së. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 7 shtator. 2021. Rasti është mbyllur.
10. Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Milazim Lushaj ndaj TV 21. Ankesa i referohet emisionit me titull “Zgjedhjet Komunale 2021”, i transmetuar në TV 21. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se TV 21 nuk e ka ftuar në debat së bashku me kandidatët tjerë të cilët garojnë për Kryetar të Komunës së Prizrenit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se TV 21 ka bërë përpjekje për të krijuar mundësinë për pjesëmarrje në debat, gjë që është pohuar edhe nga Pala ankuese. KPM ka gjetur se KTV ka përmbushur kriteret e parapara për të vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 5 tetor 2021 duke ia ofruar mundësinë e drejtës së reagimit. Rasti është mbyllur.
11. Rasti i njëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e PDK-së, Dega e Drenasit ndaj KTV-së. Ankesa i referohet emisionit me titull “Zgjedhjet në Kohë-Debat për Drenasin” të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se KTV me transmetimin e këtij emisionit nuk ka treguar profesionalizëm dhe objektivitet duke transmetuar një kronikë me qëllim tendencioz dhe denigrim të fushatës zgjedhor të kandidatit z. Lladrovci. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës pasi që ia ka dhënë hapësirën për reagim z. Lladrovci i cili ka qenë prezent në studio. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 19 tetor 2021. Rasti është mbyllur.
12. Rasti i dymbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Genc Hundozi (LVV) ndaj RTK 1. Ankesa i referohet artikullin me titull “RTK ka publikuar artikullin me titull Sondazhi nxjerr Bedri Hamzën fitues pa balotazh”. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se RTK 1 e ka transmetuar këtë artikull. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se përmbajtja programore e cila është objekt i

Ankesës nuk është transmetuar në RTK 1 dhe se rrjedhimisht vlerësimi i pajtueshmërisë së kësaj përmbajtje me Kodin e Etikës nuk ka qenë i mundur. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 19 tetor 2021. Rasti është mbyllur.

13. Rasti i trembëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Mediana Halili (Kallxo.com) ndaj RTK 1. Ankesa i referohet emisionit me titull “Kojshia Show”. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se RTK 1 ka transmetuar këtë emision ku i ftuari në emision dëshiron të gjuaj me armë në ambiente të mbyllura, gjest ky jo i hijshëm dhe jo i duhur për transmetim në një televizion. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se përmbajtja programore e cila është objekt i ankesës nuk është transmetuar në RTK 1 në platformën televizive dhe rrjedhimisht nuk paraqet çështje për trajtim nga ana e KPM-së. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 2 dhjetor 2021. Rasti është mbyllur.
14. Rasti i katërbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Shkelzen Morina (MPJD) ndaj KTV-së. Ankesa i referohet kronikës me titull “Emërimet në MPJD” të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se kronika e transmetuar ka qenë tendencioze, nuk ka pasqyruar të vërtetën, ka përmbajtur pasaktësi dhe ka qenë raportim jo i drejtë. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të nenit 10.1 të Kodit të Etikës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 23 prill 2021 që Palës ankuese t’i jepet e drejta e reagimit. Komisioni më datën 29 korrik 2021 ka marrë Vendim që Palën përgjegjëse ta sanksionojë me Vërejtje dhe që brenda 7 ditësh t’ia ofrojë mundësinë e reagimit ashtu siç përcaktohet me nenin 10.1 të Kodit të Etikës. Pala ankuese është njoftuar lidhur me Vendimin që është ndërmarr ndaj KTV. Rasti është mbyllur.
15. Rasti i pesëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Kushtrim Brahimaj ndaj Kanal 10. Ankesa i referohet emisionit me titull “Gara për Gjakovë” të transmetuar në Kanal 10. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se mysafirja e emisionit znj. Kusari Lila ka përmendur emrin e tij duke thënë të pavërteta dhe shpifje. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Kanal 10 ka bërë shkelje të nenit 10.1 të Kodit të Etikës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje më datën 29 tetor 2021, që Palës ankuese t’i jepet e drejta e reagimit. Komisioni më datën 11 nëntor 2021 ka marrë Vendim që Palën përgjegjëse ta sanksionojë me Vërejtje dhe që brenda shtatë (7) ditësh t’ia ofrojë Palës ankuese mundësinë e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10.1 të Kodit të Etikës. Pala ankuese është njoftuar lidhur me Vendimin që është ndërmarr ndaj Kanal 10. Rasti është mbyllur.
16. Rasti i gjashtëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Telkos ndaj Klan Kosova. Ankesa i referohet edicionit të lajmeve qendrore dhe emisionit në mbrëmje “Edicion special” të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Klan Kosova ka transmetuar një lajm të pavërtetë dhe të njëanshëm lidhur me OSH Telkos. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se

saktësia e të dhënave të transmetuara nga Klan Kosova nuk mund të vërtetohet dhe për këtë Komisioni më datën 26 maj 2021 ka marrë Vendim që Pala ankuese ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 10.1 të Kodit të Etikës 2016/03.

17. Rasti i shtatëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Tel Communications ndaj Kanal 10. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Kanal 10 ka transmetuar një njoftim shpifës dhe fyes duke cekur se TEL Communications është duke transmetuar Kanal 10 pa të drejtë. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e Kanal 10 dhe ka gjetur se ka bërë shkelje të nenit 6.1 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje më datën 28 qershor 2021. Pala ankuese është njoftuar më datën 9 korrik 2021 pasi që Kanal 10 e ka ndërprerë transmetimin e këtij njoftimi. Rasti është mbyllur.

Rastet e shkeljeve gjatë procesit zgjedhor

Lidhur me shkeljen e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-44 të Komisionit të Pavarur të Mediave, Rregullores KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio Vizuale dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, Departamenti Ligjor ka proceduar njëqind e njëzet e shtatë (127) raste të shkeljeve nga ana e OSHMA-ve në periudhën para fushatës zgjedhore, gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Parlamentare të muajit shkurt 2021.

Prej këtyre rasteve:

- pesë (5) raste janë para fushatës zgjedhore të cilave iu ka shkuar shkresë dhe për të cilat mëpastaj Komisioni ka marrë Vendim që t'i sanksionojë me Vërejtje;
- katërmëdhjetë (14) janë proceduar gjatë fushatës zgjedhore të cilave iu ka shkuar Njoftim për shkelje. Dy (2) prej tyre, pas Njoftimit kanë ardhur në pajtueshmëri. Komisioni ka marrë Vendim që tetë (8) prej tyre të sanksionohen me gjobë, ndërsa katër (4) prej tyre me Vërejtje;
- shtatë (7) raste janë proceduar gjatë heshtjes zgjedhore të cilave iu ka shkuar Njoftim për shkelje. Komisioni ka marrë Vendim që katër (4) prej tyre të sanksionohen me gjobë, ndërsa tri (3) prej tyre me Vërejtje;
- njëqind e një (101) raste janë për mos sjelljen e Ditarëve për zgjedhje, ku të gjithave iu ka shkuar Njoftim për shkelje. Tetëdhjetë e pesë (85) rastet pas Njoftimit për shkelje kanë ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre Komisioni ka marrë Vendim me masë sanksionuese në shumë prej njëmijë (1000) euro. Të gjitha këto raste janë mbyllur.

Rastet e shkeljes gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale, gjatë raundit të parë dhe të dytë, të mbajtur gjatë muajit tetor dhe nëntor 2021, lidhur me shkeljen e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-44 të Komisionit të Pavarur të Mediave, Rregullores KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës janë gjithsej gjashtëdhjetë e dy (62) raste, prej tyre:

- dymbëdhjetë (12) raste janë gjatë fushatës zgjedhore të raundit të parë, të cilave iu kanë shkuar shkresa dhe Njoftime për shkelje. Një (1) prej tyre pas Njoftimit ka ardhur në

pajtueshmëri. Komisioni ka marrë Vendim që nëntë (9) prej tyre të sanksionohen me gjobë, ndërsa dy (2) prej tyre me Vërejtje.

- pesë (5) raste janë proceduar gjatë heshtjes zgjedhore gjatë raundit të parë, të cilave iu ka shkuar Njoftim për shkelje dhe Komisioni ka marrë Vendim t'i sanksionojë me Vërejtje.
- pesë (5) raste janë gjatë fushatës zgjedhore të raundit të dytë, të cilave iu kanë shkuar shkresa. Komisioni ka marrë Vendim që t'i sanksionojë me gjobë.
- dyzet (40) rastet tjera janë për mos sjelljen e Ditarëve për Zgjedhje, ku të gjithave iu ka shkuar Njoftim për shkelje. Tridhjetë e nëntë (39) raste pas Njoftimit për shkelje kanë ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për një (1) prej tyre Komisioni ka marrë Vendim me masë sanksionuese në shumën prej një mijë (1000) euro. Të gjitha këto raste janë mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2021 janë bërë matje dhe monitorime në terren të sinjaleve të radio televizioneve nacionale, radio televizioneve regjionale e lokale në tërë territorin e Kosovës, për të inçizuar gjendjen e transmetimeve radio televizive tokësore në brezet frekuencore (radio FM VHF/III dhe TV VHF/III; TV UHF/IV/V). Matjet dhe monitorimet janë bërë me qëllimit të vlerësimit dhe analizimit të:

- Gjendjes për transmetimet radio televizive tokësore analoge me mbulim nacional të subjekteve të licensuara, gjegjësisht evidentimin e zonave të pambuluara me sinjal radioteleviziv;
- Gjendjes për transmetimet radio televizive tokësore analoge me mbulim regjional/lokal të subjekteve të licensuara;
- Gjendjes për prezencën e sinjaleve radio televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë;
- Evidentimit të interferencave në brezin frekuencor radiodifuziv dhe evidentimit të frekuencave të lira të mundëshme për radio transmetime në territorin e Kosovës;
- Pajtueshmërisë së radio televizioneve nacionale, radio televizioneve regjionale e lokale me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës, përkatësisht verifikimit të zonës së mbulimit.

Gjithashtu, gjatë matjeve janë monitoruar edhe radio frekuencat që shfrytëzohen nga KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulushmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë, 65 dBuV/m për TV, e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi

apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimit të rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst, KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Republikës së Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që do të arrihej mbulueshmëri e mbi 90% të territorit me sinjal televiziv kualitativ.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2020, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2021, Departamenti për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2021, të cilat kanë patur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 MHz).

DMF-ja, gjatë matjeve të bëra në terren, ka vërtetuar gjendjen e njejtë si dhe gjatë vitit paraparak që tregonë se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, dhe Radio 21 nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuv/m për këto zona. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivovë, Llabjan, Parllavë dhe Bresalc); Kaçanik–Hani i Elezit; Mitrovicë–Bajgorë; Shtime–Carrallevë, Dragash–Restelicë; Prizren–Brezovicë; Kramovik–Dollc; Pejë–Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka pranim (i dobët, nën 46dbuv/m mono) të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve është konstatuar se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2 dhe Radio 21 nuk janë duke transmetuar në pajtim me statusin e radiove nacionale duke mos arritur të mbulojnë tërë popullatën e Kosovës, ndërsa Radio Dukagjini në koordinim me KPM-në është duke e bërë zgjerimin e zonës së mbulimit në tërë territorin e Kosovës.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa në bashkëpunim me ta do të gjej lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra është vërtetuar se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM Stereo radio transmetime) dhe e paiterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth 68.14% të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth 96.98% të territorit të Kosovës (të gjitha së bashku).

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2021, DMF nuk ka pranuar ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese, radio dhe TV, që verteton se spektri frekuencor (TV dhe radio) është i sinkronizuar dhe i pa interferuar.

Rastet për transmetime të palicencuar

DMF gjatë vitit 2021 nuk ka hasur në pranim të ndonjë sinjali FM TV i cili është i palicencuar nga ana e KPM-së.

Frekuencat e revokuara nga KPM

DMF gjatë vitit 2021 nuk ka proceduar me asnjë rast për të cilën është dashur të revokohet ndonjë frekuencë (licencë).

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR

DMF gjatë vitit 2021 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Gjatë vitit 2021, radiot e huaja ndërkombëtare si BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë.

Bashkëpunimi i KPM-së me KFOR ka vazhduar për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

Gjatë vitit 2021, KPM ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me KFOR-in edhe sa i përket aspektit të frekuencave FM, ku si rezultat KFOR ka shprehur gatishmëri të pajiset me licencë për frekuencat FM radio të cilat shfrytëzohen nga Radio KFOR.

Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit

Gjatë vitit 2021, DMF ka pranuar kërkesë për ndryshim të kategorisë (nga lokal në regional) nga Radio UBT në Lipjan, ku pas analizave kjo kërkesë është aprovuar nga Komisioni.

Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së

Gjatë vitit 2021, DMF ka proceduar me një rast të një subjekti transmetues (Urban FM) i cili ka bërë ndryshimin e pikës së transmetimit pa miratimin e KPM-së, ku pas verifikimit është kthyer në pikën transmetuese për të cilën është i licencuar nga KPM.

Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë

Gjatë vitit 2021, një numër shumë i madh i TV-ve me mbulim regional kanë pasur ndërprerje të transmetimit tokësor. Nga matjet në terren është konstatuar se: TV Besa, TV Opinioni, TV Prizreni, TV Festina, TV Liria, TV Syri Vision, TV Dukagjini, TV Zoom dhe TV Mitrovica gjatë vitit 2021 kanë pasur ndërprerje të vazhdueshme të transmetimeve tokësore (pa e informuar KPM-në). Ndërsa, me probleme më të vogla në transmetim tokësor kanë qenë TV Herc, TV Most dhe TV Mir.

Po ashtu, matje janë bërë edhe për sinjalin FM radio ku është konstatuar se: Radio Bubamara, Radio Hayat, Radio Kent FM (Mamushë), Kent FM (Prishtinë), Radio Bambus, Radio Kllokoti, Radio Bravo, Radio Borzani, Radio Herc, Radio Kaçaniku, Radio Ferizaj, Radio Energjia, Radio Shqip FM, Top Iliria Radio, Radio Antena, Radio Dodona dhe Radio Gora nuk janë duke respektuar licencën e KPM-së, pra kanë bërë ndërprerjen e transmetimit pa e njoftuar KPM-në.

Plani frekuencor dhe dixhitalizimi

Gjatë vitit 2021, DMF ka bërë përditësimin e planit të frekuencave për transmetim tokësor televiziv dixhital në Republikën e Kosovës, si obligim nga Ligji për Digjitalizim në Republikën e Kosovës.

DMF ka bërë matje në terren lidhur me verifikimin e kanaleve të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim dixhital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinje.

Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinje

Nga matjet në terren janë regjistruar një numër i caktuar i sinjaleve televizive dixhitale që vijnë nga territori i vendeve fqinje, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, ngjashëm me vitin 2020.

Matjet e bëra kanë përfshirë tërë territorin e Kosovës me theks të veçant pikat nacionale të transmetimeve radio televizive tokësore analoge si dhe lokacionet pranë kufirit me shtetet fqinje.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Buxheti për Komisionin e Pavarur të Mediave për vitin 2021 është i bazuar në Ligjin me Nr.07/L-041 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/L-016 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në Ligjin Nr.07/L-041 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 më datën 06.01.2021, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-016 me 06.08.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 15.12.2021 dhe 29.12.2021 ka marr vendim për të aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndryshimet buxhetore të Organizatave Buxhetore. Në këto ndryshime është e përfshirë edhe KPM.

Bazuar në Vendimet e Qeverisë, ndryshimet buxhetore të KPM-së janë si në vijim:

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, Buxheti fillestar në vlerë prej 832,740.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogluar në vlerë prej 701,562.94 €.

Në kategorinë e pagave dhe rrogave është tërhequr shuma në vlerë prej 97,902.90 € dhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është tërhequr shuma në vlerë prej 33,275.15 €.

Gjithsejtë totali i shumës së tërhequr nga Buxheti fillestar është shuma në vlerë prej 131,178.05 €.

Nga totali i Buxhetit final në vlerë prej 701,562.94 € është shpenzuar shuma në vlerë prej: 640,235.53 € apo 91.26 % dhe Buxheti i pa shpenzuar është në vlerë prej 61,327.41 €.

Buxheti i Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2021				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe Rrogat	448,914.99	351,012.09	351,012.09	0.00
Mallra dhe Shërbime	305,826.00	272,550.85	271,397.73	1,153.12
Shërbime Komunale	28,000.00	28,000.00	17,825.71	10,174.29
Projekti Kapital				
Sist.Elekt.r.e-KPM-UPS	50,000.00	50,000.00	0.00	50.000.00

Total:	832,740.99	701,562.94	640,235.53	61,327.41
--------	------------	------------	------------	-----------

Buxheti i shpenzuar sipas Kategorive ekonomike:

I. Paga dhe Shtesa

Bazuar me Vendimin nr.11/52 të datës 29.12.2021, Buxheti final në kategorinë e pagave dhe rrogave në raport me Buxhetin fillestar është zvogëluar për shumën në vlerë prej 97,902.90 €.

Në kategorinë e pagave dhe rrogave, Buxheti fillestar në vlerë prej 448,914.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 351,012.09 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 351,012.09 € apo 100%.

II. Mallra dhe Shërbime

Bazuar me Vendimin nr. 02/48 të datës 15.12.2021, Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në raport me Buxhetin fillestar është zvogëluar për shumën 32,747.60 €. Ndërsa, me Vendimin nr. 11/52 të datës 29.12.2021, Buxheti final në raport me Buxhetin fillestar është zvogëluar për shumën në vlerë prej 527.55 €. Totali i shumës së tërhequr është në vlerë prej 33,275.15 €.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, Buxheti fillestar në vlerë prej 305,826.00 € është zvogëluar në vlerë prej 272,550.85 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 271,397.73 € apo 99.58%.

III. Shërbime Komunale

Në kategorinë e Shërbimeve Komunale, nga totali i Buxhetit final në vlerë prej 28,000.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 17,825.71 € apo 63.66%, ndërsa Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 10,174.29 €.

IV. Projekte Kapitale

Në kategorinë e Projekteve kapitale është i aprovuar Projekti Kapital “Sistemi Elektronik-e-KPM-UPS”, me kodin e projektit nr. 18874, në vlerë prej 50,000.00 €. Mjetet kanë qenë të zotuar, por Projekti nuk është realizuar për arsye të procedurave me vonesë të tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës nga AQP më datë 16.12.2021.

1.2 Realizimi i të Hyrave

KPM mbledhë të hyra nga ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, si dhe operatorët e shpërndarjes, si: tarifa për aplikim të licencës, tarifat vjetore të licencës, tarifa për ndryshim dhe vazhdim të licencës dhe gjobat. Këto të Hyra përmes llogarisë së KPM-së kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në Rregulloren 2017/06 për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë të KPM-së, të Licencuarit nga KPM obligohen të paguajnë tarifën për licencë në baza vjetore për

secilin vit fiskal. Afati për pagesën e tarifave vjetore të të licencuarve të KPM-së është data 30 qershor i vitit respektiv.

KPM prej tarifës së licencës për vitin 2021 ka planifikuar që të realizojë të hyra në vlerë prej 269,770.00 €.

Nga të hyrat e mbledhura prej Komisionit të Pavarur të Mediave, janë gjeneruar 362,893.70 €, prej tyre 331,991.58 € u takojnë të hyrave nga tarifa për licencë, shuma prej 28,790.02 € u takojnë të hyrave nga gjocat dhe shuma prej 2,112.10 € u takojnë të hyrave nga dënimet për media (kamatë).

Në kuadër të Realizimit të të Hyrave është përfshirë vlera e të hyrave të mbledhura për vitin 2021 me vlerë prej 267,074.67 € dhe të hyrat e realizuara të viteve paraprake janë në vlerë prej 95,819.03 €. Shuma totale e realizimit përfshinë edhe një pjesë të kthimit të mjeteve të shërbimeve të përmbaruesit privat.

Gjatë periudhës raportuese kemi një rritje prej 76,371.55 € apo 26.65% më tepër krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

1.3 Të Arkëtueshmet nga tarifa për Licencë

Obligimet nga tarifa për licencë dhe gjocat të cilat kanë statusin e të arkëtueshmeve në vlerë prej 728,267.08 €, janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave.

Nga shuma totale, shuma në vlerë prej 482,304.11 € janë obligime financiare nga tarifa për licencë, shuma në vlerë prej 21,382.97 € nga kamatat, ndërsa shuma në vlerë prej 224,580.00 € janë obligime nga gjocat.

Obligimet për mos pagesën e tarifës vjetore për licencë nga viti 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe për vitet 2014-2021 janë proceduar te përmbaruesi privat.

Në kuadër të Ll/A në vlerë prej 728,267.08 € është e përfshirë vlera e Ll/A të krijuara në vitin 2021 në vlerë prej: 138,210.77 € dhe Ll/A të viteve paraprake në vlerë prej 590,056.31 €.

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) në vlerë prej 728,267.08 €, në krahasim me vitin paraprak ka rritje në shumën në vlerë prej 58,645.15 € (669,621.93 € në vitin 2020) apo 8.76 %.

Në Shtojcën IIIa është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit (**Shtojca IIIa Raporti Vjetor Financiar 2021**).

PUNA E BORDIT PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 29 tetor 2020, ka emëruar për anëtar të Bordit për Ankesa z. Ylber Fetahaj me mandat tre (3) vjeçar dhe z. Avdyl Hyseni anëtar të Bordit për Ankesa me mandat tre (3) vjeçar, ashtu siç parashihet me nenin 40, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, ndërsa me Vendimin e datës 29 dhjetor 2020, e ka zgjedhur z. Ylber Fetahaj si Kryetar të Bordit për Ankesa.

Më 15 mars 2021 i ka përfunduar mandati një anëtarit të Bordit dhe prej kësaj date Bordi nuk është në përbërje të plotë dhe as funksional, në pritje të emërimit të anëtarit të tretë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë që ky organ të jetë funksional.

Përbërja e Bordit për Ankesa gjatë vitit 2021

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Ylber	FETAHAJ	Kryetar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Avdyl	HYSENI	Anëtar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Ilaz	RUDAKU	ish - Anëtar	15 mars 2018 deri më 15 mars 2021	mandat tre (3) vjeçar

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA), gjatë vitit 2021, ka mbajtur dy (2) seanca shqyrtuese, ku ka shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së. Në mbledhjen e Bordit për Ankesa e mbajtur me datën 16 prill 2021, në të cilën Kryetari ka konstatuar praninë e vetëm një anëtarit në takim dhe skadimin e mandatit të anëtarit të dytë, gjë që ka bërë që Bordi për Ankesa të mos ketë kuorum për trajtimin e ankesave ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së. Pas kësaj date Bordi për Ankesa i ka kthyer përgjigje të gjitha Palëve ankuese duke i informuar që është jofunksional për faktin se nuk është në përbërje të plotë prej tre anëtarësh, deri në zgjedhjen e anëtarit nga Kuvendi i Kosovës dhe i ka udhëzuar që të vazhdojnë procedurat ligjore bazuar në legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2021, Bordi ka trajtuar rastet si në vijim:

Seancën e parë shqyrtuese Bordi për Ankesa e ka mbajtur më 6 janar 2021, ku janë shqyrtuar rastet e paraqitura në vijim:

- Ankesa e RTK 1, e parashtruar më datën 7 dhjetor 2020, ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si të bazuar ankesën e RTK 1 dhe e ka anuluar Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 duke e kthyer rastin në rivendosje.
- Ankesa e KTV, e parashtruar më datën 7 dhjetor 2020 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e KTV, duke e vërtetuar Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03.

Seancën e dytë shqyrtuese Bordi për Ankesa e ka mbajtur më 12 mars 2021, në të cilën ka shqyrtuar katërmbdhjetë (14) ankesa të parashtruara kundër Vendimeve të Komisionit të KPM-së, ku janë shqyrtuar rastet e paraqitura në vijim:

- Ankesa e RTK 1, e parashtruar më datën 8 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e RTK 1, por Vendimi me Vërejtje i shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03, mbetet në fuqi.
- Ankesa e Klan Kosova e parashtruar më datën 10 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e Klan Kosova, duke e vërtetuar Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.
- Ankesa e TE7, e parashtruar më datën 5 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e TE7, dhe Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 5000 euro në 4000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- Ankesa e TV Syri Vizion, e parashtruar më datën 11 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e TV Syri Vizion dhe Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 2000 euro në 1000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- Ankesa e TE7 e parashtruar më datën 5 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e TE7, duke e vërtetuar Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.

- Ankesa e KTV e parashtruar më datën 8 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e KTV, duke e vërtetuar Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele KPM-2017/07.
- Ankesa e Klan Kosova, e parashtruar më datën 10 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e Klan Kosova dhe Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 5000 euro në 4000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- Ankesa e KTV, e parashtruar më datën 8 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e KTV dhe Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 5000 euro në 4000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- Ankesa e operatorit të shpërndarjes Telkos e parashtruar më datën 24 shkurt 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e Telkos, duke e vërtetuar Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, lidhur me ankesën e operatorit të shpërndarjes Teklos ndaj operatorit të shpërndarjes Artmotion për shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuele KPM-2020/01.
- Ankesa e Shell BI, e parashtruar më datën 4 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e Shell BI duke e vërtetuar Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, lidhur me ankesën e Shell BI kundër Radio Kosova1 dhe Glam Radio, për shkelje Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele KPM-2017/07.
- Ankesa e RTK1, e parashtruar më datën 10 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e RTK1 dhe Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 5000 euro në 4000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- Ankesa e operatorit të shpërndarjes Kujtesa Net e parashtruar më datën 3 mars 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e Kujtesa Net, duke e vërtetuar Vendimin e shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, lidhur me ankesën e operatorit të shpërndarjes Kujtesa Net ndaj OSHMA Klan Kosova për shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuele KPM-2020/01.
- Ankesa e operatorit të shpërndarjes Kadria Net e parashtruar më datën 26 shkurt 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të refuzojë si të pabazuar ankesën e Kadria Net, duke e vërtetuar Vendimin e shqiptuar nga ana e

Komisionit të KPM-së, lidhur me ankesën e operatorit të shpërndarjes Kadria Net ndaj OSHMA Klan Kosova për shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuele KPM-2020/01.

- Ankesa e TV Puls, e parashtruar më datën 12 shkurt 2021 ndaj Vendimit të Komisionit. Pas shqyrtimit, Bordi për Ankesa vendosi të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e TV Puls dhe Vendimin shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me masën gjobë e ka zbritur nga 2000 euro në 1000 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.

OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA PËR VITIN 2021

Gjatë vitit 2021 kanë qenë të planifikuara objektivat e mëposhtme, por për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, nuk është arritur të realizohen shumë prej objektivave, e të cilat barten për vitin 2022.

Objektivi 1

Avancimi i kornizës ligjore

- Amandamentimi i Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele;
- Amandamentimi i Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale;
- Amandamentimi i Rregullores për Përcaktimin e Tarifës për Licencë të KPM-së;
- Miratimi i Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave.

Objektivi 2

Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Krijimi i një platforme ndër-institucionale për promovim dhe zhvillim të edukimit medial, duke definuar qartë rolin e KPM-së në këtë platformë.

Objektivi 3

Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)

- Faturimi elektronik;
- Databasa për futjen e të dhënave të aktiviteteve brenda KPM-së;
- Qasja e publikut në mënyrë elektronike.

Objektivi 4

Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror

Inicimi i ndërtimit të rrjetit për transmetim dixhital në nivel shtetëror;

Licencimi i MUX-ave në pajtim me Ligjin për Transmetim Dixhital.

OBJEKTIVAT E VITIT 2022

Objektivi 1

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies

- Azhurnimi i adresarit për pronësinë mediale
- Informimi publik mbi ndryshimet pronësore dhe ato të licencave
- Rishikimi i Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuele
- Parandalimi dhe luftimi i operimeve ilegale audiovizuele
- Efikasiteti i sanksioneve

Objektivi 2

Promovimi i pluralizmit medial

- Përfshirja aktive në përgatitjen e Ligjit të ri për KPM-në
- Miratimi i Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave
- Mbështetja e prodhimit të përmbajtjeve programore vendore
- Rishikimi i Rregullores për Tarifat Vjetore për Licencë

Objektivi 3

Mbrojtja e publikut dhe grupeve të cenuara

- Rritja e aktiviteteve mbi edukimin medial
- Promovimi i respektimit të kodit të etikës
- Monitorimi i vazhdueshëm i përmbajtjeve të dëmshme programore, përfshirë gjuha e papërshtatshme, gjuha e urrejtjes dhe dezinformimin.
- Rishikimi i Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele
- Promovimi i gjuhës së shenjave në përmbajtje programore

Objektivi 4

Përdorimi eficient i resurseve frekuencore

- Rishikimi i planit frekuencor në brezin e transmetimit
- Komunikimi dhe koordinimi frekuencor me shtetet fqinje
- Analizimi i procesit të dixhitalizimit

Objektivi 5

Rritja e efikasitetit dhe mirëqeverisjes institucionale

- Dixhitalizimi i shërbimeve
- Promovimi i mekanizmave ankimore
- Shtimi i masave mbrojtëse nga sulmet kibernetike
- Hulumtimi periodik i tregut medial
- Rritja e bashkëpunimit me partnerët vendor dhe ndërkombëtar

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT

Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare

Shkurtime buxhetore nga Ministria e Financave, po pamundësojnë funksionimin e KPM-së si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme. Gjithashtu, sfida mbetet edhe mos lejimi i shfrytëzimit të të hyrave nga tarifat vjetore të licencave siç përcaktohet me Ligjin për KPM-në, e që është element shtesë që garanton pavarësinë e institucionit.

Nevoja për rritjen e numrit të stafit

Në vazhdimësi, KPM-ja ka parashtruar kërkesa për shtimin e numrit të stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlidhen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM-ja është rritur dukshëm, përfshirë edhe paraqitjen e platformave të reja mediale si rezultat i zhvillimeve teknologjike, duke shtuar volumin e detyrave për nëpunësit ekzistues.

Aktualisht, KPM-ja është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësojë edhe punën e KPM-së në zbatimin e Ligjit për KPM-në dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2020

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Sipas opinionit të auditimit, Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjatë auditimit nuk është dhënë asnjë rekomandim. Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020 ka vlerësuar dhe ka dhënë opinion të pamodifikuar.

Deri në përfundim të periudhës raportuese, ende nuk është kryer auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2021.